

Qëndrimi i AKEP për komentet e palëve të interesuara për këshillimin publik të dokumentit “Projekt-Rregullore për Mënyrën e Zbatimit të Portabilitetit të Numrit”¹

(Pjesë e dokumentacionit të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP me Nr.2, datë 2.02.2026, për miratimin e Rregullores “Për Mënyrën e Zbatimit të Portabilitetit të Numrit”)

¹ Dokumenti “Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numritu publikua për këshillim publik në faqen e internetit të AKEP dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 18.07.2025.

AKEP me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.7, datë 12.06.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik “*Projekt-Rregullore për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit*”. Dokumenti u publikua në faqen e internetit të AKEP-it më datë 18.06.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 18.07.2025. Në përfundim të procesit të këshillimit publik në AKEP depozituan komente palët e interesuara si më poshtë:

- Sipërmarrësi One Albania sh.a., me shkresën Nr.1654 Prot., datë 17.07.2025 (Ref.AKEP: Nr.1146 Prot, datë 17.07.2025);
- Sipërmarrësi Vodafone Albania sh.a., me shkresën me referencë LEA/055/LR.EM.EK, datë 18.07.2025 (Ref.AKEP: Nr. 1146/1 Prot, datë 18.07.2025).

AKEP, falenderon palët e interesuara për komentet dhe sugjerimet e dhëna,² të cilat janë dhënë më poshtë të sintetizuara sipas pyetjeve të këshillimit publik së bashku me qëndrimin e AKEP për komentet e dhëna.

² AKEP pas përfundimit të procesit të këshillimit ka zhvilluar dy takime më datat 12.09.2025 dhe 16.12.2025, me qëllim diskutimin dhe qartësimin ndryshimeve të propozuara të rregullores dhe komenteve të dërguara nga palët e interesuara, përfshirë aspektet teknike dhe operacionale me dy operatorët celularë si dhe me operatorin e CRDB.

Adresa: Rr. “Reshit Çollaku” Tiranë, Tel : ++ 355 4 2259 571 Fax : ++ 355 4 2259 106, www.akep.al , info@akep.al

2.1 Përkufizimet/termat e reja të Ligjit 54/2024

Pyetje nr.1:

A jeni dakord me ndryshimet dhe/ose shtesat e propozuara për përkufizimet e termave në pikat 1, 5, 5/1, 6, 6/1, 6/2, 7 dhe 7/1 të Nenit 4 të Projekt-Rregullores?

VODAFONE

Koment nr.1: Vodafone është dakord me ndryshimet e propozuara për përkufizimet në pikat e përshkruara si më lart.

ONE

Përgjigje: Në parim jemi dakord me përditësimin e përkufizimeve, por është e nevojshme një harmonizim më i plotë i përkufizimeve në Rregullore të cilat në cdo rast duhet të jenë në linjë me përkufizimet dhe përcaktimet e Ligjit. Sjellim në vëmendje rastin e përkufizimit të numrit aktiv, në pikën 12 të nenit 4, pasi në sistemet e operatorëve, numri “deaktiv” mund të ketë një tjetër kuptim nga momenti të cilit i ka përfunduar kontrata, ndaj dhe draft rregullorja duhet gjithmonë të referojë “terminimin e kontratës” lidhur me përkufizimin e numrit aktiv.

Gjithashtu, lidhur me përkufizimet në pikën 19, shkronja (a), kërkojmë që fatura e muajit aktual të mos përfshihet në përkufizimin e “detyrimit” pasi në zbatim të legjislacionit në fuqi, pajtimtari ka afate ligjore brenda së cilës gëzon të drejtën të paguajë detyrimet e tij ndaj dhe fatura e muajit aktual nuk përbën detyrim për tu paguar në kuptim të ligjit.

Qëndrimi i AKEP

AKEP në përkufizimin në pikën 13 të Nenit 4 ka shtuar “(i terminuar)” pas termit “Numër i Çaktivizuar” me qëllim saktësimin e termave. Pikat 12 dhe 13 përmbajnë sqarime të mjaftueshme për dallimin midis statusit “aktiv” dhe “çaktivizuar/terminuar”, përfshirë për rastet e numrave që i janë ndërprerë përkohësisht shërbimet, nuk kanë bërë rimbushje etj, që në sistemet e operatorëve konsiderohen “deaktiv” apo “pasiv”, të cilët për qëllime të Rregullores së Portabilitetit konsiderohen “aktiv”, pra jo të “çaktivizuar/terminuar”.

2.2 Fusha e zbatimit dhe parime të përgjithshme

Pyetje nr.2:

A jeni dakord me ndryshimet në Nenin 4 (Fusha e Zbatimit dhe Parime të përgjithshme) të Projekt-Rregullores?

VODAFONE

Koment nr.2: Vodafone është dakord me ndryshimet e propozuara në Nenin 5 (Fusha e Zbatimit dhe Parime të përgjithshme).

ONE

Përgjigje Në përgjithësi jemi dakord me ndryshimet e bëra, por nevojitet të bëjmë një saktësim lidhur me pikën 2 të tij, sugjerojmë të hiqet togfjalëshi “...dhe në një vendndodhje të caktuar gjeografike që i përket të njëjtit rajon gjeografik/zonë numeracioni si para bartjes” pasi me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Rregullores Nr.10 për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, me VKD nr. 2361 dt. 29.10.2015, zbatohet plani i hapur i numeracionit dhe nuk ka kufizime lidhur me rajonin gjeografik.

Qëndrimi i AKEP:

Ndryshimet në Rregulloren Nr.10, datë 11.08.2009 për “*Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike*”, nëpërmjet VKD nr.2631 date 29.10.2015, janë të lidhura me numërformimin për kryerjen e thirrjeve telefonike drejt numrave fiks, dhe jo me zonat gjeografike të numeracionit fiks për qëllime alokimi sekondar apo portimi të numrit. Ndryshimet e kryera në vitin 2015 mundësojnë numërformimin e thirrjeve drejt numrave fiks sipas Planit të Mbyllur të Numeracionit (Closed Numbering Plan): 0+NDC+Subscriber Number.³ Këto ndryshime janë refelktuar dhe në marrëveshjet e interkoneksionit dhe tarifimin e thirrjeve për përdoruesit fundorë, me kalimin nga terminim/tarifim me tre nivele në një nivel. Por zonat gjeografike/NDC-të e numrave fiks NDC nuk janë hequr dhe ato aplikohen ende në Shqipëri dhe kudo (me përjashtime të rralla), pasi ato shërbejnë për qëllime lokalizimi për shërbimet e emergjencave, sigurisë, transparencës për kosnumatorë etj.

Pika 2 e nenit 5 të Rregullores së portabilitetit përcakton që një numër fiks i pajtimtarit (subscriber number) nuk mund të portohet në një zonë gjeografike tjetër me NDC të ndryshme, duke plotësuar/sqaruar përcaktimet e pikës 1/a të Nenit 126 të Ligjit 54/2024, e cila është në përfrim të plotë me përcaktimet e EECC (Aneksi VI, Pjesa C/a), që aplikohet në të gjitha vendet e BE-së (dhe më gjerë).

Pyetja nr.3:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me sqarimet e dhëna nga AKEP në këtë shpjegues në lidhje me portabilitetin e numrave gjeografikë në vendndodhje të ndryshme gjeografike, portabilitetin e numrave të përdorur për komunikime M2M, portabilitetin e numrave 0800 etj.?

VODAFONE

Koment nr.3: Për sa i përket portabilitetit të numrave të përdorur për komunikime M2M, sqarimi është shterues në shpjeguesin në fund të draft Rregullores, por në Nenin 5 nuk përmendet qartazi portimi i numrave të këtij funksioni. Kjo nënkuptohet në përkufizimin e pikës 1 ku thuhet: “*Kjo Rregullore zbatohet vetëm për portabilitetin e numrave të caktuar përdoruesve fundorë/pajtimtarëve nga sipërmarrësit për përdorim për shërbim publik telefonik/komunikim zonor që i përkasin kategorive të mëposhtëme të numrave në PKN*” .

Gjykojmë se për të mënjeluar çdo lloj paqartësie, është e nevojshme të specifikohet në Rregullore në një nënpikë të Nenit 5 sipas sqarimeve të dhëna nga AKEP në Shtojcën 1, se kjo Rregullore nuk zbatohet për portabilitetin e numrave të përdorur për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike që nuk janë shërbime të komunikimit ndërpersonal sipas përkufizimit të Ligjit 54/2024 të tilla si numrat e përdorur për komunikimet M2M, pasi këto nuk janë komunikime ndërpersonale apo shërbim publik telefonik/komunikim zonor

ONE

Përgjigje: Shoqëria One Albania ndan të njëjtin mendim me AKEP se portimi i numrave për komunikimet M2M mund të kryhet me marrëveshje vullnetare. Ndërsa lidhur me numrat 0800 mendojmë se procesi është tepër i ndërlikuar, dhe mënyra e alokimit të këtyre numrave është subjekt i Rregullores për Numeracionin.

Qëndrimi i AKEP

AKEP nuk mendon se është e nevojshme përfshirja e një nënpike të vecantë për përjashtimin zbatimit të Rregullores për portimin e numrave të përdorur për ofrimin e shërbimeve të

³ Para këtyre ndryshimeve numërformimi për thirjet lokale nuk përfshinte 0+NDC, por vetëm Subscriber Number.

komunikimeve elektronike që nuk janë shërbime të komunikimit ndërpersonal (si M2M), pasi pika 1 e nenit 5 e përcakton qartë fushën e zbatimit të saj.

Në vijim dhe sqarimeve në Shpjeguesin për Projekt-Rregulloren e nxjerrë në këshillim publik, AKEP sqaron sërish:

- Neni 126 I Ligjit 54/2024 parashikon që përdoruesit fundor kanë të drejtë të kërkojnë portim të numrave që ata kanë nga të gjitha kategoritë e numrave (gjeografikë dhe jogjeografikë) nga plani kombëtar i numeracionit;
- Përcaktimet e Rregullores (si edhe të Rregullores 43/2016) nuk zbatohen për:
 - o portabilitetin e numrave gjeografikë në vendndodhje të ndryshme gjeografike (portabilitet gjeografik i numrave fiks)
 - o portabilitetin e numrave midis për ndryshim shërbimi nga shërbim nga rrjet fiks në shërbim nga rrjet i lëvizshëm (portabilitet i shërbimit)
 - o portabilitetin e numrave të përdorur për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike që nuk janë shërbime të komunikimit ndërpersonal sipas përkufzimit të Ligjit 54/2024 të tilla si numrat e përdorur për komunikimet M2M, pasi këto nuk janë komunikime ndërpersonale apo shërbim publik telefonik/komunikim zanor.
 - o portabilitetin e numrave jogjeografikë që janë numra të kategorive të përcaktuara në nën-pikat b-d, pika 26 e Nenit 4 të Ligjit 54/2024 si numrat për shërbimet me vlerë të shtuar/me tarifë premium; numrat 0800 xxxx; numrat për shërbim publik telefonik nomadik.

Ndërkohë, portimi i numrave (fiks ose celular) të përdorur për komunikimet M2M mund të kryhet me marrëveshje vullnetare midis ODH dhe OM.

Ndërsa për portabilitetin e numrave të tjerë, AKEP do të vlerësojë përcaktimin e rregullave shitesë në një kohë të mëvonshme, për shkak dhe të proceseve më të ndërlikuara për portabilitetin e këtyre numrave. Aktualisht për numrat jo-gjeografike si numrat 0800 që alokohen nga AKEP direkt për përdoruesit fundorë (alokim parësor), përdoruesit e tyre nuk kanë nevojë për të drejtë portimi/portabilitet pasi ata zotërojnë të drejtën e përdorimit të numrit (si ofrusit/operatorët që pajisen me të drejtë përdorimi nga AKEP për numrat fiks dhe të lëvizshëm) dhe kanë mundësinë e zgjedhje së operatorit të rrjetit se ku do të hostojnë këto numra, dhe ndryshimit të mëpashëm të tyre. AKEP do të vlerësojë mundësitë për ndryshime në mënyrën e alokimit të këtyre numrave, për të alokuar numrat 0800 vetëm operatorëve të rrjeteve (alokim parësor), dhe alokimi (dytësor) për përdoruesit fundorë i numrave 0800 (apo dhe kategori të tjera) të kryhet vetëm nga operatorët e rrjeteve që kanë marrë grupe/seri nga këto numra nga AKEP.

2.3 E drejta/mundësia e bartjes së numrit nga pajtimtari/përdoruesi fundor

Pyetje nr.4:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përcaktimet e reja në Nenin 16, pika 7 të Projekt-Rregullore për ruajtjen e së drejtës së portimit të numri pas përfundimit të kontratës?

VODAFONE

Koment nr.4: Vodafone në parim është dakord për për ruajtjen e së drejtës së portimit të numri pas përfundimit të kontratës, por për një periudhë deri në një muaj, pasi numri të jetë çaktivizuar, për të qenë në linjë edhe me parashikimet e Ligjit nr. 54/2024 në nenin 145 pika 5, i cili parashikon afatin minimal 1 muaj: “ Kur një përdorues përfundon një kontratë, ai ruan të drejtën për portimin e një numri nga Plani Kombëtar i Numeracionit te një ofrues tjetër, për të paktën një muaj nga data e përfundimit të kontratës së mëparshme, përveç rastit kur përdoruesi fundor heq dore nga kjo e drejtë”.

ONE

Përgjigje: ONE Albania në parim nuk e mbështet propozimin e AKEP për ruajtjen e së drejtës së portimit të numrit pas përfundimit të kontratës, dhe implementimin e statusit “Numër i Caktivizuar”, për disa arsye të lidhura me teknikalitete dhe me operacionalitetin në sistemet tona ku mund të përmendim si më poshtë:

- Referuar dhe marrëdhënive kontraktuale aktuale me paspagim, nëse numri me kontratë ndërpritet, vlerësojmë se numri nuk duhet të ruhet, apo të kalojë në statusin “Numër i Caktivizuar”, pasi ne si ofrues të shërbimeve e kemi përfunduar marrëdhënien kontraktuale me klientin dhe nuk kemi më asnjë detyrim kontraktual apo ligjor ndaj tij;
- Edhe në rastin kur një kontratë me paspagesë është terminuar për detyrime të pashlyera, të dhënat personale dhe financiare të abonentit mund të jenë ende në sistem për një afat të caktuar kohor sipas detyrimeve ligjore, por të dhënat teknike të kartës SIM dhe MSISDN invalidohen duke kaluar në një status Inactive sic dhe është aktualisht implementimi në sistemet tona;
- Në rastin kur numri është me parapagesë dhe ka kaluar në status joaktiv, nisur dhe nga operacionaliteti në sistemet tona, nuk mbështesim vijimin e procesit të portabilitetit dhe futjen e një statusi të ri “Numër i Caktivizuar” pasi nga ana jonë për sa dhe si është ndërtuar arkitektura IT-së, Billing-u, etj aktualisht nuk mund të ruajmë numra joaktivë në këto sisteme, pra numra që nuk kanë kryer rimbushje sipas ciklit të jetës së kartës SIM me parapagesë të përcaktuar në politikat komerciale nga ONE Albania.
- Gjithashtu, vlen të theksojmë se në rastet e ndërprerjes vullnetare të kontratës nga ana e pajtimtarit, kërkesa për terminim kontrate nga ana e abonentit shpreh pastër vullnetin e tij të pandikuar për të mbyllur shërbimet me një operator të caktuar. Në kushtet kur portabiliteti i numrit zbatohet prej rreth 15 vitesh, dhe të gjithë abonentët janë në dijeni dhe kanë informacion të plotë që në rast se shërbimi i ofruar nga një sipërmarrës nuk plotëson nevojat e tij apo nuk është në cilësinë e pretenduar, ai mund të ndërrojë operator pa ndërruar numrin, vendosja e detyrimit për ruajtjen e të drejtës së portimit edhe pas terminimit të kontratës vjen si barrë e rëndë për operatorin. Në gjykimin tonë, duket se më shumë se dhënia e një përvoje më të mirë abonentit, shtimi i këtyre përcaktimeve për ruajtje të së drejtës së portimit të numrit pas përfundimit të kontratës do të përkthehet në kosto të shtuar, të drejtpërdrejtë për sipërmarrësit për zhvillimet/përditësimet në sistemet e tyre, pa asnjë përfitim.

Megjithatë, pavarësisht nga vështirësitë tona dhe mos-justifikimin e proporcionalitetit të vendosjes së këtij detyrimi për operatorët për rrethanat dhe problematikat e procesit të portimit në Shqipëri, duke njohur zhvillimet dhe praktikën e vendeve të EU-së në implementimin e Kodit European të Komunikimeve Elektronike (këtu e më poshtë EECC), transpozimin e tij në Ligjin Organik të fushës për

secilin nga vendet e EU-së, dhe implementimin përkatësisht në këto vende, dhe shtuar këtu aprovimin e këtyre përcaktimeve dhe në Ligjin tonë 54/2024, e mirëkuptojmë qasjen e AKEP për implementimin e dispozitave të reja të Ligjit.

Por, në linjë edhe me përcaktimet e Ligjit, në nenin 145, pika 13, AKEP përcakton me rregullore detajet e procesit të portimit duke mbajtur në konsideratë kushtet teknike për realizimin e portimit. Ndaj dhe në këtë kontekst do të kërkonim që dispozitat e propozuara në projekt-rregullore që mundësojnë ruajtjen e të drejtës për portimin e numrit përtej përfundimit të kontratës të mos shtrihen përtej periudhës minimale 1 muajore që përcakton EECC dhe Ligji nr. 54/2024. *(detajet në përgjigje të Pyetjes nr. 5 më poshtë)*

Gjithashtu, lidhur me kohën e implementimit të këtyre ndryshimeve, për të cilat AKEP propozon një afat prej 6 muajsh, shoqëria ONE Albania konsideron të pamundur implementimin e këtyre zhvillimeve në një afat kaq të ngushtë kohor.

Sjellim në vëmendjen tuaj se, imponimi i detyrimeve për zhvillime teknike, të sistemeve dhe infrastrukturës IT, e BI është pazgjidhshmërisht i lidhur me kërkesa shtesë për investime, të cilat gjithashtu do të duhet të konsiderohen nga Autoriteti Juaj.

Vetë AKEP, në Shtojcën shpjeguese sqaron dhe është i vetëdijshëm se “...Ndryshimet e mësipërme për ruajtjen e së drejtës së pajtimtarit për të portuar një numër të çaktivizuar nga ODH, përbëjnë ndryshim të rëndësishëm dhe me impakt në proceset e brendshme të operatorëve si ODH, përfshirë databazën e pajtimtarëve të referuar në Pikën 4/iv të Nenit 18, ku ODH përvec statusit të numrit (Aktiv/Çaktivizuar) duhet të ruajë dhe datën e Çaktivizimit të numrit, dhe kjo datë do të shërbejë për llogaritjen e afatit 3 mujor të cituar më sipër.”

Ndaj i kërkojmë AKEP që cdo lloj vendimmarrje e AKEP lidhur me këto përcaktime në vendimin përfundimtar për aprovimin e Rregullores do të duhet të konsiderojë maksimalisht kohën, kostot, periudhën dhe afatet e përshtatshme që i nevojiten operatorëve për përmbushjen e tyre. Shoqëria ONE Albania ka dhënë qëndrimin e propozimin e saj për vendosjen e një periudhe tranzitore 24-mujore për përcaktimet që kërkojnë zhvillime, në përgjigje të pyetjes nr. 18 së bashku me argumentat përkatës.

Pyetje nr.5:

A jeni dakord me propozimin e AKEP për vendosjen e afatit simetrik 3 mujor për:

- *lindjes së të drejtës për ri-portim numri aktiv (përcaktim 7ere71 I Rregullores 43/4016)*
- *lindjes së të drejtës për portim për 7ere të numrit aktiv;*
- *ruajtjen e së drejtës për portim të numrit të çaktivizuar (Ligji 54/2024 përcakton vetëm afatin minimal Të paktën 1 muaj)?*

VODAFONE

Koment nr.5: Vodafone është dakord me afatin 3 mujor të lindjes së të drejtës për portim për herë të parë të numrit aktiv.

Për sa i përket afatit të ruajtjes së të drejtës për portim për tre muaj pasi një numër është çaktivizuar, Vodafone Albania gjykon se më i përshtatshëm do të ishte një afat 1 muajor, i cili përputhet edhe me minimumin e caktuar në ligjin Ligji 54/2024. Kjo pasi ka më shumë gjasa që pajtimtari të interesohet për portimin e një numri brenda një afati më të shkurtër se sa tre muaj pasi numri ka kaluar në statusin joaktiv.

Lidhur me rikthimin e numrave në operatorin fillestar (operatori që ka të drejtën e përdorimit të numeracionit nga AKEP) në mënyrë periodike, nga eksperiencia e deritanishme rezulton se mund të

ketë numra që duhen rikthyer sipas afateve të caktuara në këtë draft Rregullore të cilët mund të kenë detyrime të pashlyera. Për këta numra sugjerojmë që të përjashtohen nga rikthimi i programuar periodik (pra, në 5 ditët e para të çdo tre mujori), dhe të lejohen të qëndrojnë në rrjetin e operatorit marrës për një periudhë më të gjatë, derisa të kenë shlyer detyrimin e prapambetur. Ndërkohë, nëse ka kërkesa nga operatori dhënës fillestar për të aktivizuar numrat, të procedohet rast pas rasti duke i njoftuar për shlyerjen e detyrimeve dhe pas shlyerjes të vijohet me rikthimin. Kjo praktikë është ndjekur nga operatorët deri tani dhe ka patur sukses në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura.

ONE

Përgjigje: Lidhur me propozimin për përcaktim të afatit të njëjtë 3 muaj, për 2 pikat e para, pra të gjithë abonentët si ata që marrin një numër për herë të parë, ashtu dhe ata që portohen nga rrjeti i një operatori në një rrjet të një operatori tjetër të kenë detyrimin e qëndrimit për një periudhë tremujore në këtë rrjet para se t’iu lind e drejta e portimit, One Albania e mbështet vendosjen e afatit 3 mujor edhe për numrat e rinj (aktiv për herë të parë në rrjet). Kjo, pasi edhe në terma të sigurimit të një përvoje më të mirë të abonentit është më se i arsyeshëm një afat tremujor për të testuar shërbimet, cilësinë, aplikacionet e mundshme dhe se sa ‘friendly-user’ janë ato, tarifimin dhe detajimet përkatëse, etj.

Ndërkohë për pikën e tretë “...ruajtjen e së drejtës për portim të numrit të caktizuar edhe pas përfundimit të kontratës..”, përtej faktit që në parim nuk e mbështetim këtë propozim, sic dhe theksuam më lart, në përgjigje të pyetjes 4, ONE Albania thekson vecanërisht kërkesën e saj që edhe në rast vendimmarrjeje nga AKEP për të vijuar me shtimin e këtij përcaktimi, Rregullorja duhet të përcaktojë eksplicitisht të drejtën e ruajtjes së numrit për portim **jo më vonë se 1 muaj nga data e terminimit të kontratës**, periudhë kjo e cila respekton dhe përmbush edhe kërkesat e përcaktuara në Ligjin 54/2024, neni 145, pika 5 e tij.

Sjellim në vëmendjen tuaj praktikën e vendeve europiane, ku përgjithësisht është përcaktuar afati 1 muaj nga përfundimi i kontratës për ruajtje të së drejtës së portimit të numrit.⁴ Në dokumentin e publikuar nga Cullen International, 12 nga 14 vendet të EU-së të marra në analizë kanë përcaktuar afat 1-mujor të mundësisë së portimit të numrit pas përfundimit të kontratës.

Gjithashtu, vlen të theksojmë se përcaktimi i afatit 1-mujor i mundësisë së portimit të numrit pas përfundimit të kontratës shmang cdo lloj problematike tjetër që mund të vijë si rezultat i politikave të operatorëve për ndjekje të pagesave të likuidimit të detyrimeve (borxhave) të prapambetura të abonentëve përmes zyrave të përmbarimit ‘outsource’, të cilat mund të përfshijnë edhe abonentë, kontrata e të cilëve ka 3 muaj që është terminuar.

Qëndrimi i AKEP (për komentet për Pyetjet 4 dhe 5)

Në vijim të komenteve të operatorëve dhe diskutimeve në takimet pas këshillimit publik, AKEP ka bërë ndryshime në versionin final të Rregullores duke reduktuar afatin e lindjes së të drejtës për portim numri (si pajtimar i ri me numër të portuar dhe/ose të ri) dhe të ruajtjes së të drejtës së pajtimtarit/përdoruesit fundor për portim numri të caktizuar/terminuar, nga 3 muaj (aktualisht për ri-portim numri dhe i propozuar dhe portim për herë të parë) në këshillim publik në 1 muaj për të tre rastet (duke ruajtur

⁴ Informacion nga Cullen International: <https://ëëë.cullen-international.com/client/site/documents/CTTEEU20220104>

simetrinë e afateve). Ky ndryshim është reflektuar në Nenin 15 dhe pjesë të tjera (si Nenet 16 dhe 18) të versionit final të Rregullores.

2.4 E drejta e pajtimtarëve me parapagim për rimbursim të krediteve të papërdorura

Pyetje nr.6:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përcaktimet e Nenit 22 të Projekt-Rregullores për Rimbursimi nga ODH të krediteve të papërdorura të shërbimit me parapagim të hartuara nga AKEP në zbatim të pikave 15 dhe 16 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024?

VODAFONE

Koment nr.6: Vodafone e mirëkupton propozimin për rimbursim të pajtimtarit për kreditin sipas përkufizimit në Draft Rregullore, kredit në të cilin nuk përfshihen paketat e blera apo bonuset e përfituara. Megjithatë rimbursimi në këtë rast paraqet disa komplikime për arsye se Vodafone e realizon shitjen e krediteve/rimbushjen e numrave nëpërmjet partnerëve/distributorëve të autorizuar që administrojnë rrjetin e dyqaneve Vodafone në të gjithë vendin. Faturat e fiskalizuara lëshohen nga këta partnerë/distributorë. Për shkak të fiskalizimit, rimbursimi mund të realizohet/procesohet vetëm në të njëjtën pikë shitjeje Vodafone ku pajtimtari me parapagesë ka kryer rimbushjen e fundit. Fatura korrigjuese për rimbursimin duhet të lëshohet nga e njëjta pikë shitjeje. Duke qenë se në 98% të rasteve transaksionet e rimbushjeve kryhen në pikat e shitjes nëpërmjet rrjetit të partnerëve/distributorëve, nevojitet kohë për të vlerësuar ndryshimet e nevojshme në sisteme dhe investimin përkatës për realizimin e tyre.

ONE

Përgjigje: Në lidhje me përcaktimet e nenit 22 të Rregullores, Shoqëria ONE Albania nuk e mbështet propozimin e AKEP për rimbursimin nga ODH të kreditit të papërdorur për abonentët me parapagesë që kërkojnë të portohen. Shoqëria ONE Albania është e qartë se këto përcaktime rrjedhin nga përcaktimet në Ligjin 54/2024, Neni 145, pika 15 dhe 16 e tij, por përcaktimi në Ligj nuk është reflektuar saktësisht në propozimin në nenin 22, pika 1 e Rregullores, e cila do të duhej të kishte të cilësuar tekstin në **bold** si më poshtë:

*1.Pajtimtarët e kategorisë konsumator që janë përdorues me parapagim të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike (të lëvizshme) kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim nga ODH për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre, **sipas kërkesës dhe kur është e mundur teknikisht, në datën e ndërprerjes së shërbimit nga ODH/datën e portimit të numrit.***

Edhe pse pikat 15 dhe 16 në nenin 145 të Ligjit nr. 54/2024, përmendin rimbursimin e krediteve, ligji e kushtëzon zbatimin me “*nëse është teknikisht e mundur*”, një element që Projekt-Rregullorja nuk e reflekton, duke e paraqitur si një detyrim të pakushtëzuar për të gjitha rastet. Po ashtu, Ligji nr. 54/2024 në pikën 16 të tij përcakton edhe “*...bazuar në specifikat e tregut shqiptar të komunikimeve elektronike...*”.

Të dy këto elementë janë shumë të rëndësishëm për tu konsideruar e vlerësuar nga AKEP në propozimin dhe më tej në vendimmarrjen e tij për të vendosur këtë detyrim kundrejt sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike.

Nën këtë kushte, Shoqëria ONE Albania Sh.A nuk mbështet dispozitën e parashikuar në Nenin 22 të Projekt-Rregullores që kërkon rimbursimin e krediteve të papërdorura për pajtimtarët me parapagim, dhe në vijim jep dhe argumentet, paraqitur më poshtë:

- Përdoruesi me parapagim rimbush me vullnet të lirë SIM-in për të marrë një shërbim specifik që është aktivizuar dhe fiskalizuar në momentin e pagesës. Në këtë moment, ofruesi i shërbimit ka alokuar burime të sistemit dhe ka përmbyllur detyrime fiskale. Rimbursimi i kreditit konsumatorit (gjithmonë në rast të kërkesës së tij), përvec plotësimit të detyrimit që vjen nga ky propozim i AKEP, në aspektin e regjistrimeve financiare kërkon pasqyrimin në llogaritë tona. Çdo rimbursim duhet të shoqërohet me një fature kredituese për vlerën e rimbursimit dhe një faturë për tarifën administrative (kur është e parashikuar në kontratë). Aktualisht, sistemet tona edhe pse mund të identifikojnë kreditin e pashpenzuar të abonentit, e kanë të pamundur gjenerimin automatik të fatures kredituese për abonentin me parapagesë të lidhur në referencë me faturën origjinale të shitjes sic kërkohet nga legjislacioni fiskal.
- Zhvillimi i funksionaliteteve të tilla nga strukturat tona IT për përkthimin e kreditit të pashpenzuar në faturë credit note kërkon ndërtimin e proceseve komplekse dhe zhvillime teknike me kosto të shtuara, ndërkohë që nuk ka asnjë përfitim të drejtpërdrejtë për operatorin, dhe gjithashtu për pajtimtarin pasi raste të tilla janë shumë të pakta dhe nuk justifikojnë investimin për zhvillime të tilla teknike. Gjithashtu, lidhur dhe me balancën e llogarisë së abonentit, aktualisht në databazat ku ruhen balancat e abonentit, për nevoja raportimi të kompanisë përditësohen 1 herë në 24 orë, që do të thotë se One Albania nuk ka gjëndjen reale të balancës së abonentit në momentin e kërkesës për portim. Pra edhe pse për AKEP duket një veprim i thjeshtë rimbursimi abonenti, ka kaq shumë teknikalitete që kërkohen, ndërthuren dhe implikohen, të cilat cojnë në kompleksitet që nuk justifikon kërkesat e mundshme të abonentit për rimbursim. Kufizimi teknik e bën procesin e rimbursimit të pazbatueshëm në praktikë, pa sjellë ndërhyrje të thella në sistemet aktuale teknike dhe kontabël.
- Përdoruesi ka të gjithë mundësinë, që me vullnetin e tij të përcaktojë një datë se kur do të ndodhë portimi, dhe nga stafet tona të shitjes këshillohet gjithmonë qëndrimi deri në përfundimin e njërive të mbetura të komunikimit nga paketa, apo të kohës bisedore të mbetur (airtime) dhe të vijojë më pas me procesin e portimit të numrit në një rrjet tjetër.
- Për më tepër, referuar të gjithë viteve prej kur është implementuar portabiliteti i numrave, nuk është evidentuar një shqetësim i tillë në treg nga pajtimtarët të cilët të kërkojnë rimbursimin e krediteve të mbetura, pasi pajtimtarët janë të ndërgjegjshëm që duhet të konsumohen përpara procesit të portimit. Ndërkohë, vecanërisht për shërbimet celulare, abonenti me parapagesë në momentin e një rimbushjeje, aktivizon një ofertë/paketë të caktuar, dhe përgjithësisht vlera e rimbushjes është e njëjtë me tarifën e ofertës/paketës së aktivizuar.
- Gjithashtu është fakt se nga praktika, numri i abonentëve me parapagesë që në momentin e kërkesës për portim kanë kredit të konsiderueshëm për të patur pretendim të qenësishëm për rimbursim të tij është shumë i vogël. Konkretisht, nga statistikat tona të brendshme, 60% e abonentëve nuk kanë kredit në momentin e kërkesës për port-out, 37% kanë kredit të mbetur

deri në 500 Leke, dhe vetëm 3% kanë kredit mbi 500 Lekë. Mesatarisht, krediti i mbetur për abonent është 56 Lekë.

Për sa më sipër, në zbatim të përcaktimeve ligjore, shoqëria ONE Albania konsideron se nuk është e mundur teknikisht implementimi i këtij zhvillimi dhe se kostoja për zhvillime të mundshme do të ishte barrë e rëndë në raport me rastet për kërkesat për rimbursim.

Pyetje nr.7:

A jeni dakord me afatet, procedurat dhe tarifën maksimale (500 Lekë me TVSH) që mund të aplikojë ODH për rastet e rimbursimeve të pajtimtarëve për kreditet e papërdorura të shërbimit me parapagim?

VODAFONE

Koment nr.7: Vodafone e vlerëson përshtirjen e kësaj tarife e cila do të ndihmonte në përbalimin e kostove administrative për realizimin e rimbursimit.

ONE

Përgjigje: Shoqëria ONE Albania nuk është dakord me përcaktimin e një tarife fikse në Projekt-Rregullore (pavarsisht vlerës) për rimbursimin e krediteve të papërdorura për përdoruesit me parapagim.

Vendosja e një tarife fikse dhe të njëjtë për të gjitha rastet nuk merr parasysh kompleksitetin e proceseve teknike dhe administrative që lidhen me rimbursimin individual të balancave, si dhe zhvillimi i këtij procesi, nëse do të miratohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje kërkon zhvillime në sistem dhe infrastrukturë, kosto për të cilat në këtë moment ONE Albania nuk mund të ketë një parashikim të saktë nëse kjo tarifë do të mbulojë këto kosto.

Gjithashtu referuar përcaktimeve të Kodit Europian të Komunikimeve Elektronike si dhe praktikës së zbatuar në vende të ndryshme të Bashkimit Europian, sugjerojmë që Rregullorja duhet të mjaftohet me të njëjtin përcaktim që permban Kodi EECC si dhe Ligji në nenin 145, pika 5 se tarifa duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të sipërmarrësit transferues për ofrimin e rimbursimit kostot aktuale të bëra nga ofruesi i shërbimit transferues për ofrimin e rimbursimit.

Për sa më sipër, në nenin 22, pika 4 të hiqet fjalia “Tarifa administrative për rimbursim duhet të jetë fikse dhe e pavaruar nga vlera e rimbursuar, por në cdo rast jo më e lartë se 500 lekë (me TVSH).”

Qëndrimi i AKEP (për komentet për pyetjet 6-7)

AKEP sqaron se ka hartuar Nenin 22 të Rregullore sipas përcaktimeve në pikat 15 dhe 16 të Nenit 145 të Ligjit 54/2024:

15. Ofruesit transferues, sipas kërkesës dhe kur është e mundur teknikisht, rimbursin konsumatorët për kreditet e mbetura ose të papërdorura të tyre në përdorimin e shërbimeve me parapagim. Ofruesi mund të aplikojë një tarifë për rimbursimin vetëm kur ajo parashikohet në kontratë. Tarifa për rimbursimin duhet të jetë proporcionale dhe në raportin e duhur ndaj kostove aktuale të sipërmarrësit transferues për ofrimin e rimbursimit.

16. AKEP-i, bazuar në specifikat e tregut shqiptar të komunikimeve elektronike dhe pas një procesi konsultimi për mundësitë teknike, miraton me rregullore mënyrat për kompensimin e përdoruesve fundorë nga ofruesit, sipas pikës 15 të këtij neni, me qëllim

sigurimin e kompensimit, në mënyrë të thjeshtë dhe duke respektuar kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Përcaktimet e mësipërme përbëjnë transpozim të pjesshëm (pra jo të plotë) të përcaktimeve të EECC (Neni 106, pika 6, Paragrafi i dytë dhe i tretë)⁵, pasi fraza e “sipas **mundësisë teknike**” e referuar pikën 16 të Nenit 146 të Ligjit 54/2024, në EECC (pika 6, neni 6) i referohet përfundimit/realizimit të **portimit over-the-air**, pra mundësisë që i gjithë procesi i portimit të kryhet në distancë (e lidhur dhe me eSIM: pajtimtari nuk ka nevojë të marrë kartë fizike SIM nga OM), dhe jo për rimbursimin e krediteve të mbetura për konsumatorin me parapagim

AKEP, nëpërmjet përcaktimeve në Nenin 22 të Projekt-Rregullores dhe versionit final të saj synojnë plotësim të kuadrit nënligjor si dhe përafrim të plotë me EECC për rimbursimin e krediteve të mbetura për pajtimtarët konsumatorë me parapagim në rastet e portimit të numrit.

Në vijim të komenteve dhe diskutimeve, AKEP në versionin final të Rregullores ka specifikuar në Nenin 22, pika 6, që rimbursimi kryhet “*duke respektuar kërkesat e legjislacionit **tatimor** në fuqi*”, si dhe ka shtuar një nënpikë (c) për mënyrë tjetër pagese/rimbursimi (sipas legjislacionit në fuqi/tatimor dhe/ose mbrojtje e konsumatorit). Mënyra tjetër pagesës/rimbursimit (përvec “cash” në pikë shitje apo “tranferte bankare”) të kreditit të mbetur me parapagim mund të kryhet nga ODH në dakordësi me konsumatorin, dhe mund të përfshijë rimbursim nëpërmjet transferimit të krediteve të mbetura (minus tarifën administrative) tek:

- një llogari tjetër klienti e konsumatorit/përdoruesit fundor apo tek një përdorues tjetër i ODH, i zgjedhur nga përdoruesi fundor;
- tek llogaria e re klientit të përdoruesit fundor me OM (ODH paguan/transferon vlerën e rimbursimit tek OM, dhe ky i fundit tek pajtimtari).
- cdo mënyrë tjetër të rënë dakord nga konsumatori/përdoruesi fundor.

AKEP sqaron gjithashtu se përcaktimet e Nenit 22 të Rregullores:

- nuk vendosin detyrim për ODH për rimbursim automatik, por me kërkesë, dhe procesi mund të kryhet në mënyrë të ngjashme rastet e tjera të rimbursimeve të tjera që kryejnë operatorët;

⁵ National regulatory authorities may establish the details of the switching and porting processes, taking into account national provisions on contracts, technical feasibility and the need to maintain continuity of service to the end-users. This shall include, ***where technically feasible***, a requirement for the porting to be completed through ***over-the-air*** provisioning, unless an end-user requests otherwise. National regulatory authorities shall also take appropriate measures ensuring that end-users are adequately informed and protected throughout the switching and porting processes and are not switched to another provider without their consent.

Transferring providers shall refund, upon request, any remaining credit to the consumers using pre-paid services. Refund may be subject to a fee only if provided for in the contract. Any such fee shall be proportionate and commensurate with the actual costs incurred by the transferring provider in offering the refund

- Pika 6/“**Pagesë në Cash në një pikë shitje të ODH**”, nuk përjashton mundësinë që ODH të kryejë/drejtojë pajtimtarin tek e njëjta pikë shitje ku ka kryer rimbushjen/pagesën e kredit;

2.5 E drejta për kompensim e pajtimtarit nga ODH/OM në rast voneseva/abuzimeve me portimin

Pyetje nr.8:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përcaktimet e Nenit 22/1 të Projekt-Rregullores për kompensimet e pajtimtarit nga ODH dhe/ose OM në rast të vonesave ose abuzimeve me procesin e portimit të numrit?

VODAFONE

Koment nr.8: Vodafone gjykon se kompensimi i pajtimtarit do të ishte i vështirë për t’u realizuar duke konsideruar gjithë ngarkesën e veprimeve operacionale për realizimin e tij duke filluar që nga identifikimi i rasteve kur ka patur realisht vonesa/abuzime për shkak të ODH dhe/ose OM. Operatori dhënës dhe operatori marrës bashkëpunojnë për realizimin e portimit sipas përcaktimeve në Rregulloren aktuale dhe ka mjaft raste kur vonesat nuk janë për shkak të ODH dhe/ose OM. Të tilla janë rastet kur pajtimtari është kontaktuar por nuk ka shkuar në një pikë shitjeje për të kryer veprimet e nevojshme për vijueshmërinë e portimit si p.sh përditësimi i të dhënave/pagesa e detyrimeve përkatëse, ose kur nuk është e mundur të kontaktohet me pajtimtarin (nuk përgjigjet). Këto raste, të cilat nuk janë shkaktuar për faj të ODH dhe/ose OM duhen mbajtur në konsideratë dhe në situata të tilla gjykojmë që vonesat e shkaktuara nga vet pajtimtari nuk duhen të **përbëjnë arsye për të kërkuar kompensim** nga ana e pajtimtarit.

Propozim: Vodafone Albania sugjeron që në Rregullore të përfshihen ato raste që vonesat e shkaktuara për faj të pajtimtarit të mos përbëjnë arsye për kompensim. Kur pajtimtari vepron me faj, ai humbet të drejtën për kompensim, pasi nuk mund të kërkohej përgjegjësi apo dëmshpërblim nga një situatë që ka ardhur si pasojë direkte e sjelljes së tij të gabuar. Parimi juridik "nemo auditur propriam turpitudinem allegans" — askush nuk mund të përfitojë nga fajësia e vet — zbatohet gjerësisht në të drejtën civile dhe kontraktore. Nëse dëmtimi ose humbja ka ardhur si rezultat i veprimeve të pamatura, të paligjshme apo të qëllimshme të vetë pajtimtarit, atëherë ai nuk mund të pretendojë të kompensohet për pasoja që vetë i ka shkaktuar. Kjo qasje mbron palën në marrëdhënie dhe garanton që kompensimi të jepet vetëm kur përgjegjësia bie realisht mbi palën tjetër.

ONE

Përgjigje: ONE Albania nuk mbështet formulimin aktual të Nenit 22/1 të Projekt-Rregullores lidhur me kompensimin automatik të pajtimtarëve në rast vonesash ose abuzimesh në procesin e portimit të numrit, për arsyet e mëposhtme:

- Mungesa e mundësisë për të verifikuar burimin real të vonesës, pasi në praktikë, procesi i portimit të numrit përfshin disa hallka të ndërlidhura, si psh:

- përpunimin e të dhënave nga përdoruesi,
- kontrollin nga përfaqësuesi i dyqanit,
- sistemet teknike të ODH dhe OM,
- ndërveprimin me CRDB,
- dhe komunikimin ndër-operator.

Në këtë kontekst, shkaku i vonesës mund të jetë:

- një gabim i të dhënave të deklaruara nga vetë pajtimtari (ID e pasaktë, numër i gabuar),
- gabim njerëzor i përfaqësuesit në pikën e shitjes,
- ose probleme teknike të rastësishme që nuk janë nën kontrollin e drejtpërdrejtë të operatorit.

➤ Nëse kompensimi imponohet automatikisht, pa një mekanizëm për të vërtetuar se kush e ka fajin apo për të analizuar shkaqet, operatorët rrezikojnë të mbajnë përgjegjësi për situata të cilat nuk i kanë shkaktuar, duke krijuar një standard të padrejtë dhe praktikisht të pazbatueshëm.

Dispozita e parashikuar në Nenin 22/1, nuk siguron objektivitet dhe zbatim të drejtë, dhe mund të çojë në kosto të panevojshme dhe konflikte midis operatorëve dhe përdoruesve.

I vetemi organ që do të mund të certifikonte përfundimisht përgjegjësinë mbi vonesën apo abuzimin do të ishte institucioni i Gjykatës. Por për tju drejtuar gjykatës, nuk ka nevojë për një rregullim të posaçëm në Rregullore pasi mbetet e drejtë e cdo individi sipas legjislacionit në fuqi.

Pyetje nr.9:

A mendoni se AKEP vlerat e kompensimit për pajtimatrin sipas Nenit 22/1 të Projekt Rregullores duhet të përcaktohen nga secili operator (si ODH dhe/ose OM) në termat dhe kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit apo duhet që AKEP të përcaktojë këto vlera të kompensimit?

Nëse PO, çfarë vlerash do të sugjeronit në varësi të vonesës dhe/ose abuzimit nga ODH/OM me procesin e portimit të numrit?

VODAFONE

Koment nr.9: Në lidhje me këtë aspekt, së pari nuk është e qartë se si do të ndikohet financiarisht pajtimtari për shkak të vonesave në procesin e portimit, ndërkohë që ka raste që vonesat gjatë procesit të portimit nuk varen nga operatorët, pasi mund të vijnë nga:

- Probleme të funksionimit të CRDB-së, të hasura në të kaluarën, duke duke çuar në tejkalim të afateve në dhënien e përgjigjeve për kërkesat e portimit, apo të hedhjes në CRDB të kërkesave për portim;
- Gjithashtu, edhe në rastet e refuzimit apo te vonesave që krijohen gjatë procesit të portimit të numrit për arsye të ndryshme, pajtimtari në asnjë moment nuk ngelet pa shërbim nga ana e operatorit dhënë, dhe në këtë pikëpamje gjykojmë se nuk ka kuptim rimbursimi i pajtimtarit;
- Ngarkesa operationale që do të krijohej për operatorët në rast të rimbursimit të pajtimtarëve për shkak të vonesave gjatë portimit të numrit.

Për sa shprehur më sipër, Vodafone shprehet **kundër propozimit të AKEP** në lidhje me kompensimin e pajtimtarit sipas nenit 22/1 të kësaj Draft-Rregullore.

ONE

Përgjigje: ONE Albania Sh.A nuk mbështet propozimin që AKEP të përcaktojë në mënyrë të centralizuar vlerat e kompensimit në rastet e vonesave ose abuzimeve të pretenduara në procesin e portimit të numrit.

Si ONE Albania, po ashtu edhe operatorët e tjerë që ofrojnë shërbimet e komunikimeve elektronike fikse apo të lëvizshme zbatojnë kushtet e përgjithshme të ofrimit të shërbimit, përfshirë të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve, si dhe procedurat e kompensimit në rast mosrespektimi të kontratës.

Në mungesë të mekanizmave objektivë për verifikimin e përgjegjësisë për vonesën apo abuzimin, vendosja e një vlerë fikse kompensimi mund të inkurajojë abuzime dhe të penalizojë operatorët në mënyrë të padrejtë, sidomos kur shkaku nuk është i lidhur me ta.

Qëndrimi i AKEP (për komentet për Pyetjet 6-7)

AKEP në versionin final të Rregullores në Nenin 22/1 ka shtuar pikën 3 si më poshtë:

3.Vonesat në procesin e portimit që mund të vijnë për shkak të veprimeve apo mos-veprimeve nga pajtimtari, apo për shkaqe objektive (arsye madhore, probleme teknike të CRDB etj.), nuk përbëjnë arsye për pajtimtarin për të kërkuar kompensim.

Gjithashtu në Nenin 22/1, pika 1, është shtuar fraza “ sipas kërkesës “, pra kompensimi kryhet me kërkesë nga pajtimtari, pra që kompensimi në mënyrë automatike nga ODH/OM nuk është detyrues. Vendosja e detyrimit për ODH/OM për kompensim automatik do të vlerësohet nga AKEP në një fazë të mëvoshme, pas implementimit të përcaktimeve të reja të Rregullores së portabilitetit, duke marrë në konsideratë dhe praktikën në vendet e BE-së.

Për i përket kundërshtimeve/mosdakordësisë së dy operatorëve për vendosjen e detyrimit të kompensimit, AKEP sqaron sërish (si edhe në Nenin 22/1 dhe në Shpjeguesin e Projekt-Rregullores për këshillim publik) se *kompensimi dhe rimbursimi i pajtimtarit për vonesa ose abuzime në procesin e ndërrimit të ofruesit të shërbimit (përfshirë me portim numri)*, si dhe *rimbursimi për kreditet me parapagim të papërdorura*, janë detyrime ligjore dhe të parashikuara në pikat 1/c/ii dhe 1/c/iii të Nenit 180 të Ligjit 54/2024 (në përafrim të plotë me përcaktimet në pikat A/3/ii dhe A/3/iii të Aneksit VIII të EECC), të cilat bëhen pjesë e marrëdhënieve kontraktuale ofrues shërbimi-pajtimtar.

2.6 Detyrime kontraktore/Pranimi me Kusht/Statusi Pezull/Njoftimet e ODH për pajtimtarin

Pyetje nr.10:

Cili është opinionimi juaj në lidhje me përkufizimet e termave të reja në pikat 19 dhe 20 të Nenit 4 të Projekt-Rregullores në lidhje me:

- “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit”
- “Detyrime kontraktore për të përmbushur me/pas përfundimit të kontratës”?

Vodafone

Koment nr.10: Për sa i përket pikes 19b të nenit 4 ku thuhet: “*Detyrimi për përdorimin e shërbimit gjatë muajit aktual sipas faturës të lëshuar/që mund të lëshohet nga ODH deri në datën e njoftimit të pranimit me kusht të*

kërkesës për portim ose në datën e pagesës nga pajtimtari së detyrimeve të referuara në këtë paragraf (pikat a dhe c) “, gjykojmë se ky nuk përbën një detyrim por një të drejtë të pajtimtarit për të përdorur shërbimin. **Propozojmë që teksti i kësaj pike të ndryshohet si vijon:** “Detyrimi për të paguar për përdorimin e shërbimit gjatë muajit aktual sipas faturës të lëshuar/që mund të lëshohet nga ODH deri në datën e njoftimit të pranimi me kusht të kërkesës për portim ose në datën e pagesës nga pajtimtari së detyrimeve të referuara në këtë paragraf (pikat a dhe c) “,

One

Përgjigje: shoqëria ONE Albania i është përgjigjur në pyetjen 1 më lart lidhur me “Detyrime kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit.

Gjithashtu, lidhur me përkufizimet në pikën 19, shkronja (a), kërkojmë që fatura e muajit aktual të mos përfshihet në përkufizimin e “detyrimit” pasi në zbatim të legjislacionit në fuqi, pajtimtari ka afate ligjore brenda së cilës gëzon të drejtën të paguajë detyrimet e tij ndaj dhe fatura e muajit aktual nuk përbën detyrim për tu paguar në kuptim të ligjit.

Qëndrimi i AKEP

AKEP ka reflektuar komentin e Vodafone në pikën 19/b të Nenit 4 të versionit final të Rregullores, ndërsa në lidhje me komentin e One sqaron se përcaktimet në pikën 19 dhe 20 të Nenit 4 të Rregullores synojnë saktësim të detyrimeve që duhet të paguajë pajtimtari ndaj ODH, dhe reduktim/eliminim të interpretimeve të ndryshme të përcaktimeve të Rregullores 43/2016, të cilat në shumë raste janë bërë objekt mosmarrëveshje midis pajtimtarit dhe/ose OM dhe ODH. Gjithashtu ato synojnë që të reduktojnë riskun e mospagesës (bad debt) nga pajtimtari të faturës/detyrimeve të muajit/periudhës së fundit ndaj ODH, duke marrë në konsideratë dhe mënyrat e ndryshme të tarifimit të pajtimit mujor nga dy operatorët celularë:

- fatura e lëshuar nga Vodafone për pajtimtarin në muajin X mbulon tarifën (fikse) e pajtimit mujor të muajit të mëparshëm (X-1) dhe cdo detyrim/shpenzim jashtë pakete (out of bundle) të kryer nga pajtimtari gjatë muajit të mëparshëm (X-1)
- fatura e lëshuar nga One për pajtimtarin (një pjesë e pajtimtarëve me paspagim celularë) në muajin X mbulon tarifën (fikse) e pajtimit mujor të muajit aktual (X) dhe cdo detyrim/shpenzim jashtë pakete (out of bundle) të kryer nga pajtimtari gjatë muajit të mëparshëm (X-1).

AKEP sqaron se përcaktimet në pikat 19 dhe 20 të Nenit 4 dhe pjesë të jera të Rregullores në lidhje me “pranimin me kusht” (apo “refuzimin” në Rregulloren 43/2016) të kërkesës për portim për shkak të detyrimeve të pajtimtarit, nuk janë detyruese për ODH por një e drejtë për ODH, dhe ODH mund të pranojë kërkesën për portim dhe më pas pajtimtari kryen pagesën e faturave sipas afateve përkatëse, dhe në raste mospagese ODH zbaton procedurat përkatëse për mbledhjen e detyrimeve të papaguara sipas legjislacionit në fuqi (versioni i Rregullores së Portabilitetit deri në vitin 2016).

Pyetje nr.11:

Cili është opiniononi juaj në lidhje me përkufizimet e termave “Miratim/pranim me kusht” dhe “Status pezull” në pikat 17 dhe 18 të Nenit 4 të dhe me ndryshimet e tjera përkatëse në Nenet 15 dhe 18 të Projekt-Rregullore në lidhje me Pranimin me Kusht të kërkesave për portim numri me paspagim që ka detyrime për të përmbushur ndaj ODH dhe krijimin e Statusit Pezull në CRDB?

A mendoni se afati 30 ditë për Statusin Pezull është i arsyeshëm për pajtimtarin (përmbushje detyrimeve përkatëse) dhe procesin e portimit? Nëse jo, çfarë afati sugjeroni?

VODAFONE

Koment nr.11: Vodafone është i mendimit se vendosja e “statusit pezull” do të ndihmojë që të ulet hedhja e përsëritur e kërkesave për portim për një subjekt të caktuar, duke ulur volumin e transaksioneve të panevojshme në CRDB. Duhet vlerësuar konkretisht se si do të jetë rrjedha e veprimeve për këtë skenar për data të ndryshme të hedhjes së kërkesës gjatë muajit. P.sh çfarë ndodh nëse një kërkesë pranohet me kusht në datën tre të muajit dhe pasi kanë kaluar 30 ditë, jemi sërish në kushtet kur do të jetë përsëri fillim muaji dhe pajtimtari do duhet të paguajë faturën e muajit paraardhës? Po sikur statusi pezull të jetë për një afat që nga data e pranimit me kusht deri në datën 4-5 të muajit pasardhës? Kështu i jepet afat pajtimtarit që të shlyejë dhe faturen e fundit të lëshuar.

Është e nevojshme që hapat që do të ndiqen në sisteme duhet të diskutohen paraprakisht edhe me Ofruesin e CRDB në mënyrë që të kemi një pamje të rrjedhës së veprimeve/komandave të përfshira për implementimin e statusit pezull. Kjo nevojitet edhe për të bërë të mundur vlerësimin për investimin e nevojshëm si edhe kohën e implementimit të ndryshimeve në sistemet e përfshira.

ONE

Përgjigje: Vendosja e statusit “Miratimit me kusht” dhe statusit “Pezull” janë mekanizma të dobishëm për të mundësuar raporte të sakta mbi normën e pranimit apo refuzimit të kërkesave për portim, siguron transparencë dhe kontribuon në reduktimin e detyrimeve të pashlyera nga ana e pajtimtarëve. Gjithashtu kosniderojmë se afati 30-ditor për përmbushjen e detyrimeve është i arsyeshëm si afat maksimal.

Megjithatë, shoqëria ONE Albania Sh.A shprehet se referuar detyrimeve e reja teknike të vendosura në projekt-rregullore, që parashikojnë imponimin e ndryshimeve teknike në sistemet operative të operatorëve dhe ndërhyrje të thella në sistemin qendror CRDB, si psh:

- ndryshime të thella në strukturën e bazës së të dhënave të CRDB-së dhe SDRB-së,
- Integrim të kushteve të reja të gjenerimit të statuseve,
- Investime të reja për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e moduleve të reja,
- Trajnim të stafit teknik dhe përditësim të procedurave të brendshme të operatorëve;

duhet të parashikohet një periudhë kalimtare e arsyeshme prej jo më pak se 24 muaj për zbatimin e këtyre proceseve teknike të reja. Po ashtu këto zhvillime duhet të ishin shoqëruar me një analizë të kujdesshme të ndikimit operacional, ekonomik apo financiar për operatorët.

Qëndrimi i AKEP

AKEP në versionin final të Rregullores (Neni 15/pika 7, Neni 16/pika 5, Neni 18/pika 5/d) ka ndryshuar afatin 30 ditor për statusin pezull të propozua në këshillim publik duke e bërë 35 ditë. AKEP sqaron se afati 35 ditor është afat maksimal dhe përfshin dhe datat 4-5 të muajit pasardhës.

Pyetje Nr.12:

A jeni dakord me vendosjen e detyrimeve shitesë për ODH për njoftimin e pajtimtarit për arsyen e refuzimit të kërkesës për portim numri përfshirë informimin për ID dhe/ose vlerëne detyrimet kontraktor të pajtimtarit ndaj ODH, sipas propozimeve në Nenet 15 (pika 11) dhe 18 (pika 12/b) të Projekt-Rregullores?

VODAFONE

Koment nr.12: Njoftimi i pajtimtarit nga ODH me SMS, mund të realizohet vetëm për sa i përket refuzimit për ID/NIPT si edhe për shumat e papaguara të faturimit mujor, por nuk është e mundur të kryhet për njoftimin e detyrimeve të tjera kontraktuale pasi detajet e kontratës përfshirë përfitime të ndryshme nuk janë të regjistruara në sistem dhe kjo kërkon kontroll manual për çdo kontratë të një subjekti. Gjithashtu në rastet kur ka detyrime për shkak të afatit fillestar minimal të kontratës, llogaritja e detyrimit kontraktual mund të jetë komplekse për kontratat që përmbajnë shumë numra që janë aktivizuar në data të ndryshme.

ONE

Përgjigje: Detyrimi për njoftim të saktë dhe të dokumentuar është në përputhje me Ligjin nr. 54/2024, parimin e transparencës dhe për të drejtën e informimit të përdoruesit fundor. Nga ana jonë vlerësohet si një element pozitiv për transparencën dhe mbrojtjen e përdoruesit, por duhet të harmonizohet me kërkesat e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave personale, për të shmangur ekspozimin apo shkeljen e detyrimeve mbi të dhënat personale.

Për këtë arsye, lidhur me përcaktimin e shtuar në nenin 18, pika 12/2, nënpika 'i' e tij sugjerojmë të hiqet parashikimi si më poshtë:

Neni 18/, pika 12:

2. ODH, jo më vonë se 8 orë/1 (një) ditë pune nga refuzimi i kërkesës për bartje për shkak të mospërfundimit të ID/NIPT ose nga pranimi me kusht i kërkesës për bartje, njofton dhe informon pajtimtarin (me SMS për operatorët celularë) për arsyen/arsyet e refuzimit apo pranimin me kusht të kërkesës për portim të numrit, duke përfshirë në këtë njoftim edhe:

i. Në rast të refuzimit për shkak të mos-përfundimit të ID/NIPT:

~~—Numrin Personal të Identifikimit (NIPT për pajtimtarët Biznes) të pajtimtarit i regjistruar tek ODH,~~

- Këshillën që pajtimtari të paraqitet në një nga pikat e shitjes së ODH, për të saktësuar të dhënat e identifikimit sipas formularit përkatës.

Qëndrimi i AKEP

AKEP ka reflektuar propozimin e One në Nenin 18/pika 12/2/i të Rregullores, duke hequr detyrimin për dërgimin e Numrit Unik Personal/NIPT.

AKEP ka reflektuar dhe komentimin Vodafone duke shtuar në fund të Nenit 18, pika 12/2/ii tekstin si më poshtë:

*Në rastin kur 1 (një) kërkesë për bartje përmban më shumë se 10 numra celularë të një pajtimtari të **kategorisë Biznes, dhe me faturim/pagesë individuale (footnote nr.7).** afati i referuar në pikën 2 shtohet me 1 ditë pune për cdo 10 numra celularë me paspagim, pjesë e së njëjtës kërkesë (shumëfishe) për portim.*

AKEP në Nenin 18, pikat 7 dhe 9, ka bërë dhe reduktimin nga 100 në 10 të sasisë së numrave në një kërkesë portimi për të cilat afati i ODH për kthim përgjigje është 3 ditë pune (në ndryshim nga afatet 5 minuta deri në 4 orë të referuar në pikën 6 të Nenit 18).

2.7 Disponueshmëria e CRDB dhe pagesat e operatorëve

Pyetje nr.13:

Cili është opiniononi juaj në lidhje me riformulimet në Nenin 10 (pikat 3-8) dhe në Nenin 21 (pikat 1-3) të Projekt-Rregullores në lidhje me sigurimin nga AKEP të disponueshmërisë së CRDB, ambienteve të hostimit, shërbimit të ofruar nga Operatori i CRDB për mirëmbajtjen dhe funksionimin e CRDB?

Vodafone

Koment nr.13: Vodafone është dakord me riformulimet e pikave 3-8 të nenit 10 në lidhje me disponueshmërinë e CRDB dhe me pavarësinë e operatorit të CRDB (ky i fundit një element mjaft i rëndësishëm i procesit të portimit).

Ndërsa në lidhje, me pikat 1-3 të nenit 21, Vodafone gjykon se llogaritja e pagesave të operatorëve që bazohet në vlerat e kontraktuara me operatorët përkatës ekonomikë të përzgjedhur nuk është e justifikuar për sa kohë operatorët nuk kanë zë në vendimmarrje në lidhje me përzgjedhjen e operatorit ekonomik (operatori i CRDB-së, apo operatori hostues), si dhe asnjë mundësi kontrolli në lidhje me shpenzimet mbi vlerat e kontraktuara. Për më tepër nuk kemi mundësi parashikimi të buxhetit duke qenë se shuma që AKEP i paguan operatorit të CRDB ndryshon cdo vit për arsye të nevojave që ka operatori ekonomik për investime ose për mirëmbajtje të CRDB-së.

One

Në lidhje me ri-formulimet në nenin 10 (pikat 3-8) i vlerësojmë korrekt dhe sqaruese në aspekt të transparencës për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike, duke qenë se janë dhe kontribuesit direkt për mbulimin e koston financiare vjetore të shpënzimeve për CRDB-në.

Lidhur me përcaktimet në nenin 21, pikat 1-3, mbi mbulimin e koston financiare nga sipërmarrësit, mekanizmin e llogaritjes së pagesave të tyre, Shoqëria ONE Albania mendon se nevojitet rishikim i përcaktimeve në këto pika për:

- përfshirje në mbulimin e koston financiare të CRDB-së të të gjithë operatorëve të tregut që direkt apo indirekt gëzojnë përfitimet e operimit të CRDB-së,
- ndryshim në skemën e llogaritjes së pagesës vjetore të CRDB-së për operatorët,
- dhe, përcaktim i përqindjes së pjesës së buxhetit (koston financiare të CRDB-së) që duhet të mbulohet nga të gjithë operatorët dhe pjesës së buxhetit që do të mbulohet nga operatorët që kryejnë portime në vitin paraardhës.

Sa më sipër, propozimet tona dhe argumentat mbështetës janë trajtuar gjërësisht në përgjigje të pyetjeve 14 dhe 15 në vijim.

2.8 Formula për pagesat e operatorëve për disponueshmërinë e CRDB

Pyetje nr.14:

Cili është opiniononi juaj në lidhje me formulën aktuale për pagesat e operatorëve për disponueshmërinë e CRDB në proporcion me përfitimet në bazë të sasisë së numrave të portura (port-in) si OM (pika 3 e Nenit të 21 të Projekt-Rregullores dhe Rregullores 43/2016)?

A reflekton ajo kontribute sipas operatorëve në mënyrë të drejtë/proporcionale me përfitimet e të gjithë operatorëve nga aksesit në CRDB, për portim të numrave dhe rrugëzim të thirrjeve drejt numrave të portuar?

VODAFONE

Koment nr.14: Siç është evidentuar dhe në Shtojcën 1 të draft rregullores, numri i portimeve nga viti 2020-2024, ka pasur një rënie të konsiderueshme. Procesi i portabilitetit të numrit është më i stabilizuar gjatë viteve të fundit, gjë që ka çuar dhe në një ulje të ankesave të pajtimtarëve.

Për këtë arsye, AKEP duhet të shoh mundësinë e uljes së kostove në lidhje me operimin e CRDB-së, e cila reflektohet në këtë mënyrë dhe në një reduktim të pagesave që kryejnë operatorët për shërbimet e ofruara nga CRDB.

Pagesat e kryera nga Vodafone Albania për portabilitetin e numrit kanë ardhur në rritje, siç evidentohet dhe në tabelën më poshtë gjatë periudhës 2022 - 2025:

Viti	Pagesat në AKEP (në milion lekë)
2022	✂ [Confidential information removed]
2023	✂ [Confidential information removed]
2024	✂ [Confidential information removed]
2025	✂ [Confidential information removed]

Nga sa më sipër, Vodafonë gjykon që pagesat vjetore (kosto për operatorin) të llogaritura sipas formulës aktuale rezultojnë mjaft të larta, e përkthyer në kosto gjithnjë në rritje.

Për sa më sipë, Vodafone gjykon se kostot në rritje, të llogaritura sipas formulës aktuale nuk reflektojnë në menyrë të drejtë kontributin e të gjithë operatorëve nga aksesit në CRDB, si për portimin e numrave ashtu dhe për informacionin e marrë nga CRDB për rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të portuar nga operatorët e tjerë (që ofrojnë shërbimin e tranzitimit të thirrjeve).

ONE

Përgjigje: Lidhur me pagesat që kryejnë operatorët për mbulimin e kostove financiare të disponueshmërisë së CRDB-së, në mënyrën si është përcaktuar në Rregulloren nr.43/2016 dhe formulën aktuale që aplikohet, ne mendojmë se duhet të ketë rishikime dhe formula e rishikuar duhet

të konsiderojë përfitimet e të gjithë operatorëve nga aksesimi në CRDB për portim të numrave dhe rrugëzim të thirrjeve drejt numrave të portuar. Aplikimi aktual i kësaj formule rëndon eksplicitisht vetëm operatorët të cilët realizojnë portime ‘port-in’ gjatë një viti të caktuar në rrjetet e tyre.

Vlen të theksojmë, se në dy vitet e fundit, vitin 2024 dhe 2025, mbulimi i kostos vjetore të CRDB-së, i është faturuar vetëm 13 operatorëve⁶ nga ~200 operatorë që operojnë në tregun e komunikimeve elektronike.

Ndërkohë që disponueshmëria e CRDB-së i shërben të gjithë operatorëve të tregut, për 2 arsye kryesore:

- Disponibiliteti, funksionimi dhe mirëmbajtja e CRDB-së i shërben cdo operatori pavarësisht faktit nëse ka realizuar ‘port-in’ në rrjetin e tij, pasi edhe pse mund të mos ketë kryer ‘port-in’ në një periudhë të caktuar, që ai të përfitojë nga funksionalitetet e CRDB-së në një moment të dhënë kur i lind mundësia e realizimit të portimit, disponibiliteti i CRDB-së nuk vendoset atë moment por është një proces mirëmbajtjeje dhe zhvillimi i vazhdueshëm, për realizimin e të cilit cdo operator do të duhej të kontribuojë përmes një pagese fikse, që garanton aksesueshmërinë dhe përdorimin e CRDB-së.
- Realizimi i rrugëzimit të thirrjes drejt numrave të portuar është një proces automatik që kërkon sinkronizim të bazës së të dhënave lokale pasqyrë të numrave të bartur të operatorëve dhe bazës së të dhënave referencë të centralizuar të CRDB-së cdo 6 orë.

Pikat 2 dhe 3 të nenit 8 të Rregullores aktuale referojnë që:

- 2. *Operatori i rrjetit dhe shërbimeve të lëvizshme, në të cilën origjinohet thirrja, është përgjegjës për rrugëzimin e thirrjes (transferim direkt), ose dërgimin e mesazheve drejtuar numrave të bartur në të gjitha rrjetet, në të cilat numrat e bartur janë vendosur....*
- 3. *Operatorët e komunikimeve elektronike të shërbimeve publike të telefonisë fikse, si dhe operatorët që tranzitojnë thirrjet midis rrjeteve, janë përgjegjës për rrugëzimin e duhur direkt të thirrjeve në numrat e bartur të rrjeteve të tjera fikse duke përdorur metodën "All Call Query – kërkimi për çdo thirrje".*

Pra, përdorimi i funksionaliteteve të CRDB-së nga operatorët për sinkronizim të të dhënave të bazës lokale dhe bazës referencë, realizimi i rrugëzimit përmes “all call query”, etj., janë procese që sigurojnë thirrjet drejt/nga numrat e portuar, dhe të cilët garantojnë vijueshmërinë e shërbimit/trafikut për cilindo operator pavarësisht cili operator ka kryer port-in të një numri në rrjetin e vet.

Sic dhe citohet në shtojcën e dokumentit, pika 2.8 “...CRDB u shërben të gjithë operatorëve të komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimit publik telefonik për përdoruesit fundorë/pajtimtarë dhe ofrues të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve, dhe CRDB komunikon cdo 6 orë me LBPS-të e të gjithë këtyre operatorëve që kanë detyrime të lidhen me CRDB por edhe përfitim nga kjo lidhje/akses (marrin informacion të përditësuar për cdo portim dhe të gjithë numrat e portuar), pavarësisht nëse përfitojnë ose jo numra si OM”.

Sa më sipër, ONE Albania mendon se **Neni 21 - Mbulimi i kostove financiare dhe pagesat** në projekt-Rregulloren e propozuar duhet të përditësohet, të rishikohet dhe të përcaktojë një mekanizëm të ri i

⁶ Bazuar në informacionin e AKEP të ndare me emel për llogaritjen e pagesës së ONE Albanisë për CRDB-në

cili të konsiderojë në mënyrë të drejtë të gjithë operatorët aktivë, operues në Tregun e Komunikimeve Elektronike për kontribuimin në mbulimin e kostove financiare të CRDB-së.

Pyetje Nr.15:

A jeni dakord me propozimin dhe shpjegimet e AKEP në seksionin “Formula për pagesat e operatorëve për disponueshmërinë e CRDB” të kësaj Shtojce, që AKEP me akt të vecantë (apo me një proces të vecantë këshillimi publik) të përcaktojë dhe një tarifë fikse vjetore e cila të jetë e njëjtë për të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimit publik telefonik për përdoruesit fundorë/pajtimtarë dhe ofrues të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve midis rrjeteve, (pavarësisht nëse kanë përfituar ose jo numra si OM)?

Nëse PO, a mendoni se AKEP duhet të përfshijë mundësinë e vendosjes së tarifës fikse në Nenin 21 të versionit final Projekt-Rregullores dhe më pas të kryejë një proces të vecantë këshillimi publik?

VODAFONE

Koment nr.15: Vodafone është dakord me propozimin për vendosjen e një tarife fikse vjetore e cila të jetë e njëjtë për të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike. Në praktikë p.sh operatorë të tjerë të cilët nuk e përdorin platformën e CRDB-së për portim, e përdorin për funksione të tjera të cilat kanë të bëjnë me njohjen dhe rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të portuar. Në këtë aspekt do të kishte sens që edhe këta operatorë të kontribuojnë në mbarëvajtjen dhe operimin e shërbimit.

Ndarja e kostove midis të gjithë përdoruesve të platformës do të ketë rezultate pozitive për operatorët kryesorë të cilët paguajnë tarifa vjetore të larta, të cilat kanë ardhur në rritje nga vitit në vit (elaboruar më në detaj në pikën 14 më poshtë), për shërbimin e CRDB-së, edhe pse numri i portimeve në përgjithësi ka rënë rreth 80% përgjatë viteve 2020-2024 (sipas të dhënave në shtojcën 1 pika 1 të Dokumentit për Konsultim Publik.

ONE

Përgjigje: ONE Albania në parim e mbështet qasjen e AKEP për vendosjen e një tarife fikse e cila të jetë e njëjtë për të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike, ofrues të shërbimit publik telefonik për përdoruesit fundorë/pajtimtarë dhe ofrues të shërbimit të tranzitimit të thirrjeve midis rrjeteve.

Por duke konsideruar që buxhetet e parashikuara nga AKEP për funksionimin dhe mirëmbajtjen e CRDB-së kanë ndryshime të rëndësishme nga viti në vit për rritje apo për ulje, mendojmë se më shumë se përcaktimi nga AKEP i një tarife fikse si detyrim vjetor për t’u paguar nga operatorët e komunikimeve elektronike për disponueshmërinë dhe aksesin në CRDB, do të ishte më e drejtë një ndarje e pjesës së buxhetit vjetor të parashikuar për CRDB-në nga AKEP, në % për tu mbuluar nga pagesat fikse të operatorëve, dhe në % për tu mbuluar nga pagesat proporcionale të operatorëve (sipas numrit të portimeve të realizuara).

Kjo pasi, në vite të caktuara për arsye zhvillimesh të ndryshme, për arsye të rritjes së sigurisë (back-up shtesë të platformës, etj) parashikimi i buxhetit për CRDB-në mund të jetë i konsiderueshëm, dhe vendosja apriori e një tarifë vjetore fikse/operator, e pandryshueshme në vite, do të thotë që gjithë barra e mbulimit të buxhetit të rritur i transferohet operatorëve që kanë kryer port-in në rrjetet e tyre në vitin paraardhës. Ndërkohë që përfitimet nga zhvillimet, siguria e rritur etj, i përfitojnë njëlloj të gjithë operatorët, pavarësisht realizimit të portimeve në një vit të caktuar.

Sjellim në vëmendjen tuaj ndryshueshmërinë e pagesave të CRDB-së për ONE Albania për Vitet 2024 dhe 2025 [Confidential information removed], si rrjedhojë e shpenzimeve të buxhetuara dhe të realizuara nga AKEP për vitet 2024 dhe 2025 me ndryshime sinjifikative nga njëri vit në tjetrin, respektivisht [Confidential information removed]. Sic mund të vërehet nga shifrat e faturuara për ONE Albania dhe kostot financiare të CRDB-së për tu mbuluar nga pagesat e operatorëve, në vitin 2024, ONE Albania ka mbuluar më shumë se 50% të kostove financiare të CRDB-së, edhe pse funksionalitetet e shtuara dhe investimet për rritjen e sigurisë kibernetike, back-up, etj, janë komponentë që sjellin përfitime në vite dhe për të gjithë operatorët e tregut. Për më tepër, duke konsideruar se Sistemi i portabilitetit të numrit (CRDB) është klasifikuar si infrastrukturë kritike kombëtare (informacion i AKEP në sqarimet për faturimin e CRDB-së për vitin 2024), mbulimi i kostove financiare të tij duhet të bazohet në kontributin e të gjithë operatorëve të tregut.

Ndërkohë, është e kuptueshme dhe e pritshme që operatorët të cilët realizojnë ‘port-in’ përgjatë periudhës 1-vjecare të kontribuojnë në pagesa më të larta të CRDB-së për atë vit. Në këtë kontekst, ONE Albania e shihet të arsyeshme dhe propozon një ndarje të mbulimit të buxhetit të parashikuar nga pagesat e operatorëve në raportin 20% nga pagesat fikse, dhe 80 % nga pagesat proporcionale.

Konkretisht, pagesa për CRDB-në propozojmë të jetë shumatore e dy komponentëve:

- (a) Pagesë fikse/operator, totali i të cilave duhet të konsiderojë mbulimin e 20% të shpenzimeve vjetore të buxhetuara nga AKEP për disponueshmërinë, mirëmbajtjen, zhvillimin, e hostimin e operatorit të CRDB-së për një vit financiar kalendarik.
- (b) Pagesë proporcionale për operatorët që kanë kryer ‘port-in’ e cila llogaritet përmes një formule të ngjashme me formulën aktuale, por me ndryshimin që do të mbulojë 80% të kostove financiare të CRDB-së.

Sa më sipër, si dhe në përgjigje edhe të pikës 2 të pyetjes 15, ONE Albania i sugjeron AKEP-it rishikimin e nenit 21 “Mbulimi i kostove financiare dhe pagesat” në këtë proces konsultimi publik dhe propozon riformulimin e pikës 3 të tij si më poshtë:

3. Pagesat e operatorëve të komunikimeve elektronike të referuara në pikën 2 të këtij neni do të llogariten nga AKEP bazuar në:

- a. *totalin e vlerave përkatëse të shpenzimeve të parashikuara në buxhetin vjetor të AKEP, apo të kontraktuara me operatorët përkatës ekonomikë të përzgjedhur sipas procedurave të parashikuara në Pikën 3 të Nenit 10 të kësaj Rregulloreje (Operatorin e CRDB, dhe/ose sipas rastit dhe operatorin ekonomik të ambienteve të hostimit dhe/ose operatorin ekonomik që ofron platformën (hardëare) dhe sistemet e operimit (softëare) të CRDB (për herë të parë dhe/ose përmirësime të mëvonshme të nevojshme të saj/tyre)).*
- b. *Ndarjen e shpenzimeve të buxhetuara për tu mbuluar si kosto financiare në raportin 20% me 80%, ku nga pagesat fikse për cdo operator do të mbulohet 20% e buxhetit të parashikuar, dhe nga pagesat proporcionale të operatorëve bazuar në numrin e ‘port-in’ të realizuara prej tyre do të mbulohet 80% e buxhetit të parashikuar.*
- c. *Sa më sipër, llogaritja përkatësisht e pagesës vjetore për CRDB-në për cdo operator do të jetë sipas formulës së mëposhtme:*

Pagesa/operator = Pagesë Fikse (mbulon 20% të buxhetit) + Pagesë Proporcionale (mbulon 80% të buxhetit)

Ku, Pagesa Fikse është njëlloj për të gjithë operatorët, dhe llogaritet si:

(20% x buxheti i parashikuar)/nr.operatorëve aktivë në treg gjatë vitit financiar/kalendarik të mëparshëm

Dhe, Pagesa Proporcionale bazohet në numrin e portimeve të realizuar nga operatori dhe llogaritet si:

[(80% x buxhet parashikuar)/Sasi totale numrash të portuar] x numra të portuar/operator

Qëndrimi i AKEP (për komentet për Pyetjet 13-15)

AKEP ka bërë disa ndryshime në versionin final të Rregullores në Nenin 21, duke reflektuar komentet e operatorëve për një ndarje më të drejtë të shpenzimeve për portabilitetin e numrit midis të gjithë operatorëve që përfitojnë nga shërbimi i lidhjes/aksesit në CRDB (operatorë ofrues të shërbimeve publike telefonike, përfshirë tranzitues të thirrjeve), pra jo vetëm Operatorët Marrës. Ndryshimet në këtë nen për pagesat janë në linjë me propozimet e AKEP në seksionet 2.7 dhe 2.8 të Shpjeguesit të Projekt-Rregullores së nxjerrë në këshillim publik dhe përfshijnë:

- Mbulimin/financimin e totalit të shpenzimeve të buxhetuara të AKEP për portabilitetin e numrit:

- i. nga pagesat fikse të të gjithë operatorëve të komunikimeve elektronike/telefonike publike që kanë detyrimin (sipas kësaj Rregulloreje apo akteve të tjera ligjore dhe nënligjore)) për t'u lidhur me CRDB apo që janë të lidhur drejtpërdrejt me CRDB (lidhje fizike dhe/ose virtuale me VPN):

Detyrimi apo Pagesa Fikse/Operator është e barabartë për të gjithë operatorët e lidhur me CRDB, në vlerën 50 mijë Lek

- ii. nga pagesat proporcionale të operatorëve të komunikimeve elektronike/telefonike publike (OM), bazuar në sasinë e numrave e 'port-in' të realizuara nga secili prej tyre (si OM) në raport me sasinë totale të numrave të portuar gjatë vitit financiar/kalendarik të mëparshëm nga të gjithë operatorët.

Detyrimi apo Pagesa Proporcionale bazohet në numrin e portimeve të realizuar nga operatori dhe do llogaritet si:

[(Totali i Shpenzimeve të Buxhetura për vitin korrent sipas pikës 3/a) – Totalin e detyrimeve/pagesave Fikse sipas pikës 3/c/i) / (sasinë totale të numrave të portuar gjatë vitit financiar/kalendarik të mëparshëm nga të gjithë operatorët)] x [sasinë e numrave e 'port-in' të realizuara nga operatori përkatës si OM gjatë vitit të mëparshëm].

- cdo operator i ri që lidhet me CRDB pas datës hyrjes në fuqi të Rregullores/2.02.2026 ka detyrimin të paguajë/do faturohet nga AKEP një Tarifë për lidhje fillestare me CRDB në vlerën 20.000 Lekë, për të mbuluar kostot operacionale të nevojshme për AKEP/operatorin e CRDB për të kryer konfigurimet përkatëse.

2.9 Tarifat midis ODH dhe OM

Pyetje Nr.16:

A jeni dakord me me propozimin e AKEP në pikën 7/b të Nenit 21 të Projekt-Rregullores, që ODH të ketë të drejtë të tarifojë OM dhe një tarife (250 Lek pa TVSH) për cdo kërkesë për portim jo të suksesshëm/të refuzuar nga ODH për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM?

Nëse PO, a është tarifa e propozuar 250 lekë pa TVSH e arsyeshme?

VODAFONE

Koment nr.16: Vodafone nuk është dakord me propozimin e AKEP sipas të cilit ODH të ketë të drejtë të tarifojë OM dhe një tarife (250 Lek pa TVSH) për cdo kërkesë për portim jo të suksesshëm/të refuzuar nga ODH për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM. Është në interesin e OM që të plotësojë saktë kërkesën për portim dhe gjykojmë se gabimet në plotësimin e kërkesës për portim, janë gabime njerëzore të cilat nuk bëhen në mënyrë të qëllimshme. Procesi aktual i komunikimit me email midis specialistëve të portabilitetit nga të dy operatorët është i mjaftueshëm për të siguruar korrigjimin e kërkesave që përmbajnë lapsuse. Tarifa e propozuar prej 250 lekësh (pa TVSH), do të shtonte në mënyrë të panevojshme volumnin e punës për identifikimin e kërkesave të plotësuara jo saktë dhe potencialisht do të bëhej shkak për mosmarrëveshje midis operatorëve.

ONE

Përgjigje: ONE Albania nuk është dakord me propozimin e përfshirë në pikën 7/b të Nenit 21 të Projekt-Rregullores.

Tarifa e propozuar nuk është proporcionale dhe e mbështetur në argumenta të qenësishëm, dhe në thelb nuk mund të verifikohet nëse gabimi ka ardhur nga OM ose jo. Gjithashtu në dokument nuk ka ndonjë evidencë të bërë publike për analizë kostoje nga AKEP që të justifikojë se një kërkesë e refuzuar për shkak të një gabimi të thjeshtë në të dhëna i shkakton një kosto reale prej 250 lekësh ODH-së. Në realitet, një refuzim i tillë është automatizuar përmes sistemit CRDB, dhe përpunimi i kërkesës është minimal, pa ndërhyrje të thellë teknike.

Gjithashtu vendosja e një tarife për një proces të papërfunduar (të refuzuar) që nuk mund të jetë i matshëm dhe i qartë nëse informacioni i gabuar është nga vetë pajtimtari apo jo, nëse mospërputhjet e ID-së vijnë për shkak të formatimit apo/ose gabime njerëzore të përfaqësuesit të OM në pikat fizike të shitjes, apo dhe të ODH që në momentin e regjistrimit të pajtimtarit në rrjetin e tij, vetëm shton problematikat mes sipërmarrësve dhe nuk ndihmon në adresimin e zgjidhjes për pajtimtarin, pasi në thelb shkak i refuzimit është i paverifikueshëm dhe nuk ka mënyrë eksplicite për ta matur atë teknikisht.

Në praktikën e vendeve të EU-së nuk gjejmë një rregullim të tillë, për aplikimin e një tarife për rastet e refuzuara. Në gjykimin tonë, propozimi nuk i shërben zgjidhjes së problematikës së abonentit, por në të kundërt nxit problematika dhe mosmarrëveshje ndërmjet operatorëve.

Konkretisht, prej shumë kohësh tashmë, situata e portimeve mes operatorëve ka ndryshuar rrënjësisht, dhe vendosja e këtij detyrimi në këto kushte duket jo-proporcionale, e tejkaluar, dhe jo në përputhje

edhe me objektivat e AKEP, sic dhe përcaktohet në Ligjin nr.54/2024, neni 6 “Përmbushja e objektivave”, pika 3/(dh) e tij.

Sa më sipër, ONE Albania i kërkon AKEP mos-përfshirjen e parashikimeve të propozuara në pikën 7/(b) të Nenit 21 të dokumentit të projekt-Rregullores.

Qëndrimi i AKEP

Duke marrë në konsideratë komentte për kompleksitetin e faturimit, AKEP në version final të Rregullores ka hequr paragrafin 7/b të Nenit 21, për tarifimi nga ODH për *cdo kërkesë për portim jo të suksesshëm/të refuzuar nga ODH për shkak të gabimeve (informacion i gabuar për ID, numër telefoni) në kërkesën për portim të OM.*

2.10 Formulari i kërkesës për portim numri

Pyetje nr.17:

A jeni dakord me ndryshimet në Formularin e kërkesës për portim në Aneksin 1 të Projekt-Rregullores si dhe me bashkimin e Anekseve 1 dhe 2 të Rregullores 43/2016 në një Aneks të vetëm (Ankesin 1 në Projekt-Rregullore).

VODAFONE

Koment nr.17: Vodafone është dakord me ndryshimet e propozuara në Formularin e kërkesës për portim në Aneksin 1 të Projekt-Rregullores.

ONE

Përgjigje: E vlerësojmë këtë ndryshim pasi konsolidimi i formularëve ndihmon në thjeshtimin e procedurës për përdoruesit dhe operatorët, ndihmon në efikasitet dhe reduktim të burokracisë. Por gjithashtu sugjerojmë që Operatorët të kenë të paktën **24 muaj** për përshtatje të procedurave dhe trajnime të stafit.

Qëndrimi i AKEP

Qëndrimi i AKEP në lidhje me komentet për afatet e hyrejes në fuqi të Rregullores/përcaktimeve të reja të saj janë dhënë në qëndrimin për kompetet për Pyetjen 18 (më poshtë).

2.11 Implementimi i ndryshimeve të Rregullores së Portabilitetit

Pyetje nr.18:

Cili është opinionin juaj në lidhje me afatin 6 mujor shtesë për zbatimin nga operatorët të detyrimeve në lidhje me:

- krijimin e statusit pezull në CRDB dhe pranimin me kusht të kërkesave për portim numri nga ODH;*
- detyrimet e ODH për procesimin e automatizuar të kërkesave për portimin e numrave të çaktivizuar?*

VODAFONE

Koment nr.18: Vodafone gjykon se një afat kohor shtesë është i nevojshëm për të kryer ndryshimet në sisteme për reflektimin e detyrimeve të përcaktuara për statusin pezull dhe procesimin e automatizuar të kërkesave për portimin e numrave të çaktivizuar. Sidomos për statusin pezull, gjykojmë se mund të nevojitet kohë edhe përtej 6-mujorit të propozuar nga AKEP. Gjithsesi, duke qenë se procesi është kompleks, në mënyrë që të mund të kemi një vlerësim të saktë të investimit të nevojshëm dhe kohës të kërkuar për implementim, duhet që fillimisht të dakordësohet edhe në bashkëpunim me operatorin e CRDB si do të jetë konkretisht rrjedha e veprimeve/komandave në sisteme dhe të ndahet manuali teknik me operatorët.

ONE

Përgjigje: Shoqëria ONE Albania vlerëson përpjekjen e AKEP për të parashikuar një periudhë tranzitore, por nuk e konsideron të mjaftueshëm afatin 6-mujor të propozuar për operatorët për të përmbushur detyrimet e reja teknike të përfshira në Projekt-Rregullore, pra jo vetëm ato të cilësuar në pikat (a) dhe (b) më sipër.

Ne mendojmë se, afati i propozuar 6 muaj është shumë i kufizuar dhe nuk i jep sipërmarrësve kohën e duhur për implementimin e kërkesave shtesë të propozuara në këtë Rregullore (duke konsideruar gjithsesi qëndrimin tonë më sipër për një pjesë të tyre), në mënyrë të veçantë ato që lidhen me përcaktimet që kërkojnë zhvillime dhe implementime teknike nga sipërmarrësit në sistemet e tyre apo dhe nga operatori i CRDB-së.

Këto procese teknike kërkojnë zhvillime komplekse dhe ndërveprim shumëpalësh, zhvillim të funksionaliteteve të reja në sistemet e brendshme të operatorëve (CRM, CDRB), ndërhyrje në strukturën e bazës së të dhënave të CRDB-së (që operohet nga palë të treta), harmonizim të ndërveprimeve OM-ODH-CRDB si dhe testimet e nevojshme për të siguruar cilësinë e shërbimit për abonentin.

Këto ndërhyrje nuk janë thjesht administrative, por kërkojnë cikël të plotë zhvillimi, testimi dhe validimi. Për më tepër, për ONE Albania këto zhvillime dhe implementime shtesë qoftë në funksion të sinkronizimit me CRDB-në, qoftë së brendshmi përkthehen në buxhete shtesë dhe kosto financiare që duan kohën e vete për vlerësim, përfshirje në buxhete dhe kryerjen e prokurimeve dhe realizimin e kontratave përkatëse, qofshin vendor-ë të mundshëm apo ofrues softëare, paisjesh, etj. Gjithashtu, duke qenë pjesë e 4iG Group, kërkohet gjithashtu marrja e miratimeve nga aksioneri kryesor, c'ka shton kohën deri në realizimin e implementimeve për përputhshmërinë me përcaktimet e propozuara.

Sa më sipër ONE Albania sugjeron/propozon përditësimin/rishikimin e Nenit 27 si më poshtë:

Neni 27

Dispozita Kalimtare

- 1. Detyrimi për zbatimin nga sipërmarrësit të përcaktimeve të kësaj Rregulloreje në lidhje me parashikimet që kërkojnë implementime dhe zhvillime nga Operatorët dhe Operatori i CRDB-së do të hyjnë në fuqi **24 muaj** pas datës së miratimit të kësaj Rregulloreje .*
- 2. Përcaktimet e dokumentit “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010 do të ngelen në fuqi, për aq sa nuk bien në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje dhe aktet e tjera nënligjore të*

AKEP, deri në datën e miratimit/hyrjes në fuqi të dokumentit të specifikimeve teknike të miratara sipas kësaj Rregulloreje.

3. *Sipërmarrësit dhe operatori CRDB kanë detyrim që gjatë periudhës **24 muaj** të referuar në pikën 1 të këtij neni, të marrin të gjitha masat e nevojshme teknike dhe operacionale në mënyrë që në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të kenë implementuar në sistemet dhe procedurat e brendshme të tyre të gjitha ndryshimet e nevojshme për zbatimin e të gjitha përcaktimeve të kësaj Rregulloreje.*

Pyetje nr.19:

A mendoni se AKEP duhet të përcaktojë një afat shtesë/periudhë kalimtare për zbatimin edhe të detyrimeve të tjera shtesë për ODH dhe/ose OM?

Nëse PO, për cilat Detyrime dhe cili do të ishte afati kohor i arsyeshëm për implementimin e tyre?

VODAFONE

Koment nr.19: Vodafone e sheh si të nevojshme përcaktimin e një afati shtesë/periudhë kalimtare për procesin e rimbursimit të kreditit për pajtimtarët me parapagesë, si edhe për implementimin e njoftimit me SMS që duhet dërguar nga ODH për rastet e refuzimeve. Edhe për këto dy parashikime është i nevojshëm një vlerësim i kohës dhe investimit të nevojshëm për ndryshimet teknike që do të duhet të implementohen.

ONE

Përgjigje: ONE Albania mbështet fort nevojën për një afat më të gjatë tranzitor për zbatimin e detyrimeve të tjera të reja të parashikuara në Projekt-Rregullore, dhe sugjeron që AKEP të rishikojë strukturën e afateve në Projekt-Rregullore dhe të parashikojë afate të diferencuara për implementim, bazuar në kompleksitetin e detyrimeve dhe vlerësimin e ndikimit teknik dhe organizativ. Kjo do të garantojë zbatim cilësor, njëtrajtshmëri midis operatorëve dhe mbrojtje të interesit të përdoruesit fundor pa rrezikuar ndërprerje apo keqzbatim të proceseve.

Në cdo rast, propozimi ynë për implementimin e detyrimeve të tjera të reja të parashikuara në Projekt-Rregullore është përcaktimi i një periudhe 12 muaj nga data e aprovimit të kësaj Rregulloreje.

Qëndrimi i AKEP (për komentet për Pyetjet 18-19)

AKEP ka bërë disa ndryshime në versionin final të Rregullores në Nenet 26 dhe 27 si më poshtë:

Në nenin 26 (*Hyrja në Fuqi dhe Zbatimi*) është shtuar një pikë 2:

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues i AKEP dhe publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al.
2. Detyrimi për zbatimin e kësaj Rregulloreje, përvec përcaktimeve të referuara në Nenin 27 Dispozita Kalimtare të kësaj Rregulloreje, fillon nga data e hyrjes në fuqi të saj.

Në Nenin 27 (*Dispozita Kalimtare për Implementimin Teknik*) janë bërë shtesat e mëposhtëme (teksti me bold dhe undeline)

1. *Afati maksimal për implementimin teknik nga sipërmarrësit në sistemet e tyre të përcaktimeve të kësaj*

Rregulloreje në lidhje me:

- a. krijimin e statusit pezull në CRDB dhe pranimin me kusht të kërkesave për portim numri nga ODH (Neni 18, pika 5/b);
- b. procesimin e automatizuar të kërkesave nga ODH për portimin e numrave të çaktivizuar (Neni 18, pika 4/i);⁷
- c. njoftimin e pajtimtarit me SMS nga ODH për arsyen/arsyet e refuzimit apo pranimit me kusht të kërkesës për portim të numrit (Neni 18, pika 12/2);

është data 1.08.2026.

2. Afati maksimal për implementimin teknik:

- a. nga sipërmarrësit në sistemet e tyre të përcaktimeve të kësaj Rregulloreje në lidhje me Formularin e Kërkesës për Portim të Numrit (Aneksi 1);
- b. nga Operatori i CRDB të përcaktimeve të kësaj Rregulloreje në lidhje me afatin e kërkesave për ri-portim numri (Neni 18, pika 5/a/ii/a)

është data 15.03.2026.

3. Përcaktimet e dokumentit “Specifikime teknike për zbatimin e portabilitetit të numrit”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1318, datë 14.06.2010 do të ngelen në fuqi, për aq sa nuk bien në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregulloreje dhe aktet e tjera nënligjore të AKEP, deri në datën e miratimit/hyrjes në fuqi të dokumentit të specifikimeve teknike të miratuara sipas kësaj Rregulloreje.
4. Përcaktimet e Rregullores 43/2016 (Neni 18, pika 5/c/v; Neni 18, pika 12; Neni 18, pika 4/i dhe Aneksi 1 dhe 2) zbatohen nga sipërmarrësit deri në afatet përkatëse të implementimit teknik në sistemet e tyre të përcaktimeve përkatëse të referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni të Rregullores.
5. Sipërmarrësit dhe Operatori i CRDB kanë detyrim që gjatë periudhave tranzitore të referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni të marrin të gjitha masat e nevojshme teknike dhe operacionale për implementimin teknik në sistemet dhe procedurat e brendshme të tyre të përcaktimeve të referuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni sipas afateve përkatëse.

Komente shtesë

Përvec komenteve/përgjigjeve për ceshtjet/pyetjet e këshillimit public dy operatorët kanë dhënë komente dhe sugjerime për ceshtje të tjera të lidhura me Projekt-Rregulloren e nxjerrë në këshillim public.

Vodafone

Në Nenin 9 Njoftimi i numrit të bartur, thuhet . 1) Operatorët janë të detyruar t'i njoftojnë nëpërmjet një mesazhi zanor në formën beep tone, pajtimtarëve të tyre, bartjen e numrit, përpara kryerjes së thirrjes drejt numrave të bartur. 2) Beep tone do të jetë i njëjtë për të gjithë operatorët e do të shërbejë për të njoftuar pajtimtarët se numri është bartur.

Aktualisht ky lloj mesazhi zanor dëgjohet në çdo rast kur ka thirrje drejt numrave të bartur. Nga ana tjetër në Nenin 11 Njoftimi paraprak i përdoruesve, në pikën 1 thuhet: “Në rrjetin origjinues, operatori është i detyruar që t'i përcjellë një “beep tone” thirrësit kur kryen thirrje drejt një numri të bartur, në rast se tarifa me pakicë për thirrjet/SMS jashtë rrjetit (off-net) janë më të larta se ato brenda rrjetit (on-net)”.

⁷ Gjatë periudhës tranzitore ODH dhe OM bashkëpunojnë me njëri tjetrin për procesim manual të kërkesave për numra të çaktivizuar celular nëpërmjet komunikimeve (me email) midis skuadrave përkatëse/ri-aktivizim të përkohshëm të numrit të çaktivizuar vetëm për thirrje/SMS hyrëse dhe vetëm për qëllim portimi etj..

Pra me këtë përcaktim, kuptojmë se duhet bërë diferencim në njoftim me beep tone. Aktualisht për Vodafone Albania pjesa më e madhe e trafikut zanor nga rrjeti celular është si pjesë e integruar e paketave mujore dhe si e tillë nuk ka diferencim për tarifimin e thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit (në paketa përcaktohen minutat kombëtare drejt gjithë operatorëve në Shqipëri). Kjo do të thotë se nuk ka diferencim në tarifim. Kurse për sa i përket kostos së thirrjeve jashtë paketave (trafiku Pay as You Go) aktualisht Vodafone Albania ka kosto më të lartë për thirrjet brenda rrjetit, sesa për ato jashtë rrjetit. Si duhet vepruar në këtë rast? Duhet hequr beep tone që aktualisht dëgjohej në çdo rast për thirrjet drejt numrave të bartur?

Në lidhje me nenin 17 pika 3 të draft Rregullores, Vodafone sugjeron që pajtimtarëve t'u jepet mundësia për të anuluar kërkesën për bartje brenda afatit prej 24 orë që nga momenti kur ka plotësuar formularin dhe kërkesën për bartje tek operatori marrës. Kjo është një pikë që Vodafone e ka ngritur edhe në konsultimet pararendëse. Mundësia për anulim i shërben përmbushjes së interesit të pajtimtarit për të zgjedhur operatorin që dëshiron, përfshirë këtu dëshirën për të qendruar me operatorin dhënës, ose në rastin kur pajtimtari për arsye personale ka ndryshuar mendim në lidhje me portimin e numrit, përpara se procesi i portimit të ketë përfunduar.

Mundësia e anulimit të kërkesës për bartje do t'u garantonte pajtimtarëve çmime më të mira të shërbimeve, duke rritur në këtë mënyrë dhe konkurrencën në treg.

Propozim: Për sa më lart Vodafone propozon rishikimin e nenit 17 pika 3 dhe riformulimin përkatës, ku të parashikohet se procesi i bartjes mund të anulohet me kërkesën e pajtimtarit që ka kërkuar bartjen e, drejtuar Operatorit Marrës, brenda 24 Orëve që nga momenti që ka nënshkruar kërkesën për portim.

Qëndrimi i AKEP

AKEP në vijim të ndryshimeve të propozuara në Nenin 11 si dhe në kushtet që tarifat me pakicë për thirrjet telefonike nga operatorët nuk kanë diskriminim off-net (tarifa më të larta për thirrje drejt numrave në një rrjet tjetër/jashtë rrjetit sesa brenda rrjetit) në Nenin 9 ka bërë disa ndryshime, duke përcaktuar Beep Tone si detyrues vetëm në rastet kur operatori origjinues aplikon tarifa me pakicë për pajtimtartin e tij më të larta për thirrje drejt numrave në një rrjet tjetër/jashtë rrjetit sesa brenda rrjetit. Këto ndryshime janë në linjë me ndryshimet e propozuara në Nenin 11 të Projekt-Rregullores.

Për sa i përket mundësisë së anulimit të kërkesës për portim nga pajtimtari, AKEP vlerëson se kjo do të rriste aktivitetin e ofertave/bonuseve të ODH ndaj pajtimtarëve që bëjnë kërkesë për portim duke rënë ndesh me përcaktimet e Neneve 15 dhe 18 të Rregullores së re (dhe të mëparshme) të cilat ndalojnë ODH që të japë oferta/bonuse apo kushte të tjera favorizuese individuale për pajtimtarin që ka bërë kërkesë për portim.

ONE

Neni 18 – Kërkesa dhe përgjigja për bartje

Lidhur me pikë 14 të këtij neni, mbi afatet që Operatorë Dhënës (ODH) duhet të zbatojë për përditësimin e databazës së tij sipas pikës 4 të po këtij neni, dhe kryerjen e veprimeve të mëtejshme për pranimin dhe/ose ekzekutimin e kërkesës për portim, ne i vlerësojmë ato si shumë të ngushta dhe të vështira për tu arritur.

Duke konsideruar proceset e brëndshme që ndiqen, kohën për të procesuar mandatat e pagesave nga Skuadra e mbledhjes së detyrimeve, ose kohën e kontrollit dhe verifikimit të llogarive bankare për pagesën e abonentit e cila është gjithashtu e lidhur/e varur dhe nga aktiviteti ditor i bankave (kontrolli mund të jetë 1 herë/ditë dhe për

ditën në të cilën abonenti ka bërë pagesën, mund të mos jetë procesuar), në sugjerime për dërgimin e këtyre afateve si më poshtë:

14. ODH, menjëherë, apo maksimumi:

- brenda 4 (katër) ~~1 (një)~~ orë pune pas korrigjimit/saktësimit të të dhënave të identifikimit,
- brenda 8 (tetë) ~~4 (katër)~~ orë pune pas pagesës nga pajtimtari në një nga pikat e shitjes së ODH (16 8 orë /2 1 ditë pune pas pagesës së kryer në rrugë bankare/dorëzimit të mandat pagesës bankare nga pajtimtari) të të gjitha "Detyrimeve kontraktore për të përmbushur përpara përfundimit të kontratës/portimit të numrit" (pika 19, neni 4 i kësaj Rregulloreje)

përditëson databazën e tij të përshkruar në pikën 4 të këtij neni, si dhe kryen veprimet e mëtejshme për pranimin dhe/ose ekzekutimin e kërkesës për portim.

Neni 19 – Konfirmimi për bartje

Lidhur me përditësimet e bëra në pikën 6 të këtij neni, "Në rastin e dështimit të procesit të portimit që mund të rezultojë në humbje të shërbimit për pajtimtarin, për çfarëdo arsyeje pas pranimin të kërkesës për portim dhe mesazheve përkatës në CRDB për lëshimin e numrit nga ODH, OM duhet të informojë menjëherë ~~pajtimtarin dhe~~ ODH duke i kërkuar atij ~~ODH~~ që të riaktivizojë numrin dhe shërbimet e lidhura për përdoruesin fundor deri në portimin e suksesshëm të numrit...", **duhet të hiqet pjesa në bold** më sipër, pasi pajtimtari nuk ka shërbim dhe teknikisht nuk është e mundur të informohet.

Qëndrimi i AKEP

AKEP në vijim të komenteve/sugjerimeve të One, ka reflektuar ndryshimet propozuara në pikën 14 të Nenit 18 dhe në Nenin 19 të versionit përfundimtar të Rregullores.

Kërkesa e operatorëve për takime

Vodafone

Vodafone e mirëpret nismën e AKEP për rishikimin e Rregullores së Portabilitetit të numrit për të përshtatur e specifikuar më tej parashikimet në lidhje me procesin e portimit sipas Ligjit nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", dhe mirëkupton nevojën për ndryshimet e propozuara duke marrë shkas nga: i. eksperiencia praktike dhe problematikat e hasura në punën e përditshme për procesin e realizimit të portimit të numrave dhe ii. kërkesave për përafrimin e këtij procesi edhe më tej me parashikimet e Ligjit të ri nr. 54/2024 në transpozimin të Kodit Elektronik Europian. Megjithatë duke qenë se procesi ka mjaft kompleksitet dhe pjesa më e madhe e ndryshimeve të propozuara kanë impakt financiar qoftë në sisteme dhe/ose procese të brendshme administrative/operacionale, gjykojmë se nevojitet që para miratimit të Rregullores këto ndryshime të sqarohen më në detaje nga AKEP, e gjithashtu në bashkëpunim me operatorin e CRDB për sa i përket aspektit teknik të realizimit të tyre. Sa më sipër sugjerojmë një takim tripalësh me grupet e interesit për të diskutuar më nga afër mbi detajet teknike.

ONE

Në përfundim të komenteve tona, Shoqëria ONE Albania shprehet se mbetet e hapur për t'i diskutuar më tej komentet dhe sugjerimet e saj në takime të mundshme të organizuara nga AKEP me aktorët e tregut të komunikimeve elektronike.

Qëndrimi i AKEP

AKEP pas përfundimit të procesit të këshillimit dhe shqyrtimit të komenteve dhe kërkesave të palëve të interesuara ka zhvilluar dy takime më datat 12.09.2025 dhe 16.12.2025, me qëllim diskutimin dhe qartësimin ndryshimeve të propozuara të rregullores dhe komenteve të dërguara nga palët e interesuara/operatorët celularë, përfshirë aspektet teknike dhe operacionale me dy operatorët celularë si dhe me operatorin e CRDB (Data Baza Qendrore e Portabilitetit të Numrit). Operatori i CRDB në vijim të sqarimeve në takimin e datës 12.09.2025 ka bërë të disponueshme për dy operatorët zgjidhjet teknike të CRDB për statusin pezull, në mënyrë që operatorët të kenë kohën e nevojshme për implementimin përkatës në sistemet e tyre.

AKEP në përgatitjen e versionit final të Rregullores ka marrë në konsideratë jo vetëm komentet e dhëna më shkrim në kuadër të procesit të këshillimit publik por edhe komentet dhe sugjerimet e diskutuara në takimet e kryera pas këshillimit publik.